



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E ARSIMIT DHE SPORTIT
DREJTORIA E PËRGJITHSHME EKONOMIKE DHE SHËRBIMEVE MBËSHTETËSE
DREJTORIA E BUXHETIT DHE MENAXHIMIT FINANCIAR

Nr. 1524/1 Prot.

Tiranë, më 29.02/2024

Lënda: Dërgohet deklarata për cilësinë e sistemit të kontrollit të brendshëm, si dhe pyetëtori i vetëvlerësimit të komponentëve të menaxhimit financiar dhe kontrollit në njësitë e sektorit publik, për vitin 2023.

Drejtuar:

Znj. Risena XHAJA
SEKRETAR I PËRGJITHSHËM MINISTRIA E FINANCEVE
Bulevardi "Dëshmorët e Kombit", nr. 3, Tiranë

Në vijim të shkresës nr. 21594 datë 24.11.2023 të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë "Kërkesë për raportimin vjetor mbi sistemin e kontrollit të brendshëm dhe plotësimin e pyetëtori i vetëvlerësimit të komponentëve të menaxhimit financiar dhe kontrollit në njësitë e sektorit publik për vitin 2023", nenit 18 të ligjit nr.10296, datë 08.07.2010 "Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin" të ndryshuar, ligjit nr.9936, datë 26.06.2008 "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, Udhëzimit nr.28, datë 15.12.2011 "Mbi paraqitjen e deklaratës dhe raportit vjetor për cilësinë e sistemit të kontrollit të brendshëm në njësinë publike", të ndryshuar, Udhëzimit nr. 16, datë 20.07.2016 të ministrit përgjegjës për financat "Për përgjegjësitë dhe detyrat e koordinatorit të menaxhimit financiar dhe koordinatorit të riskut në njësitë publike", bashkëlidhur kësaj shkrese ju dërgojmë:

- Deklaratën për cilësinë e sistemit të kontrollit të brendshëm për vitin 2023;
- Pyetëtori i vetëvlerësimit të komponentëve të menaxhimit financiar dhe kontrollit në njësitë e sektorit publik për vitin 2023.
- Raportin e plani i veprimit për menaxhimin financiar dhe kontrollin për vitin 2024.

Duke ju falënderuar për bashkëpunimin,

SEKRETAR I PËRGJITHSHËM

Erzen Tola

Florian Vasa

Puno:	F. Nurçe	Përgj Sektorit Buxhetit në DBMF	
Prano:	M. Bimo	Drejtor në DBMF	
Mirato:	M.Cami	Drejtor i Përgjithshëm	
Dt. tek SP		11.03.2024	
Nr. kopjeve			



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E ARSIMIT DHE SPORTIT
DREJTORIA E PËRGJITHSHME EKONOMIKE DHE SHËRBIMEVE MBËSHTETËSE
DREJTORIA E BUXHETI DHE MENAXHIMIT FINANCIAR

Nr. 1524/2 Prot.

Tiranë, më 29.07.2024

Deklaratë për cilësinë e sistemit të kontrollit të brendshëm në Ministrinë e Arsimit dhe Sportit për vitin 2023

Unë i nënshkruari Erzen Tola, në cilësinë e Nëpunësit Autorizues dhe të koordinatorit të riskut të Ministrisë së Arsimit dhe Sportit, deklaroj se kam përgjegjësinë për menaxhimin me efikasitet, efektivitet dhe ekonomi të burimeve financiare dhe jo-financiare të njësisë, si dhe pohoj që sistemi i kontrollit të brendshëm, i ngritur nga Titullari i Njësisë, mbështet arritjen e objektivave, politikave dhe qëllimeve të njësisë, në përputhje me përgjegjësitë që më janë caktuar sipas nenit 9 të ligjit nr.10296, datë 08.07.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin” i ndryshuar.

Në cilësinë e Nëpunësit Autorizues deklaroj se kam monitoruar sistemin e kontrollit të brendshëm të Ministrisë së Arsimit dhe Sportit gjatë vitit raportues 2023, nëpërmjet:

- Koordinimit të takimeve me drejtorët e drejtorive në lidhje me identifikimin dhe vlerësimin e risqeve që vënë në rrezik arritjen e objektivave të Ministrisë së Arsimit dhe Sportit dhe ngritjen e sistemit të menaxhimit të riskut.
- Këshillimit dhe dhënies së instruksioneve menaxherëve të tjerë të Ministrisë së Arsimit dhe Sportit, në bashkëpunim me Njësinë Qendrore të Harmonizimit për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin.
- Paraqitjen e raportit të përgjithshëm të risqeve të Ministrisë së Arsimit dhe Sportit tek Ministri i Arsimit dhe Sportit dhe Grupi i Menaxhimit Strategjik të Ministrisë.

Deklaroj nën përgjegjësinë time se raporti bashkëlidhur kësaj deklaratë, pasqyron në mënyrë të besueshme efektivitetin e sistemit të kontrollit të brendshëm dhe përfaqëson plan veprimin për trajtimin e mangësive të vërejtura në sistem për të garantuar përmirësimin e tij në vazhdimësi.

SEKRETAR I PËRGJITHSHËM

NËPUNËS AUTORIZUES



Florian Krasniqi

Punoi:	F. Nurçe	Përgj. Sektorit Buxhetit në DBMF	
Pranoi:	M. Bino	Drejtorë në DBMF	
Miratoi:	M. Cami	Drejtor i Përgjithshëm	
Dt. tek SP			
Nr. kopjeve			

Shënim:

Në vitin 2022, me shkresën nr. 5976/2 datë 25.10.2022 të Departamenti të Administratës Publike, Z. Erzen Tola është liruar nga pozicioni i i Drejtorit të Përgjithshëm dhe emërohet Sekretari i Përgjithshëm.

Në vitin 2023, me Urdhër nr. 523, Datë 15.9.2023 të Ministrit të Arsimit dhe Sportit “Për Delegimin e Kompetencave tek Sekretari i Përgjithshëm”, janë përshkruar detyrat që delegohen.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E ARSIMIT DHE SPORTIT

DREJTORIA E PËRGJITHSHME EKONOMIKE DHE SHËRBIMEVE MBËSHTETËSE

DREJTORIA E BUXHETI DHE MENAXHIMIT FINANCIAR

Nr. 1524/ Prot. 3

Tiranë, më 29.02.2024

RAPORT

“PËR FUNKSIONIMIN E SISTEMIT TË KONTROLLIT TË BRENDSHËM TË MINISTRISË SË ARSIMIT DHE SPORTIT PËR VITIN 2023”.

I. PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

Ministria e Arsimit dhe Sportit gjatë vitit 2023 në përmbushje të misionit të saj, si dhe funksionimit të strukturave të sistemit, ka vijuar të rrisë performancën e punës së saj, me qëllimin realizimin me sukses të objektivave të përcaktuara në Strategjinë Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim 2022–2024, ligjin nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për Menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, ligjin nr.10296, datë 08/07/2010 “Për menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”, të ndryshuar, ligjin nr. 69/2012, datë 21.06.2012, “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar; ligjin nr.80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”; ligjin nr. 79/2017 “Për sportin”; ligjin nr.84/2022 “Për buxhetin e vitit 2023”, të ndryshuar, Vendimin nr. 90, datë 17.2.2021 Këshillit të Ministrave “Për miratimin e programit të reformave ekonomike (ERP) 2021–2023”; Vendimin nr. 621, datë 22.10.2021 “Për miratimin e strategjisë kombëtare për arsimin 2021–2026 dhe të planit të veprimit për zbatimin e saj”, detyrimet që rrjedhin nga Marrëveshja e Stabilizim Asocimit me BE, Vendimin nr. 523, datë 22.09.2021 të Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e fushës së përgjegjësisë shtetërore të Ministrisë së Arsimit dhe Sportit”, dhe detyrime të tjera sipas akteve ligjore e nënligjore në fuqi, për realizimin e objektivave dhe aktivitete e miratuara në Programin Buxhetor Afatmesëm 2022 -2024.

A) MJEDISI I KONTROLLIT

Parimi 1 - Njësia Publike demonstroi angazhim për integritet dhe vlerat etike.

Menaxherët e nivelit të lartë të njësisë publike, shprehin dhe demonstrojnë rëndësinë e integritetit dhe vlerave etike në të gjithë njësinë.

Për të garantuar një menaxhim financiar dhe kontrolli në përputhje me legjislacionin përkatës, kërkesat e buxhetit si dhe parimet e menaxhimit financiar, me transparencë, efektivitet, efikasitet dhe ekonomi, në Ministrinë e Arsimit dhe Sportit janë krijuar tashmë sistemet e kontrollit të brendshme, të cilat janë gjithmonë në përmirësim duke synuar drejt përmbushjes optimale të objektivave.

Në mbështetje të nenit 27, të ligjit nr.10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, të ndryshuar, procesi është drejtuar dhe koordinuar nga Grupi për Menaxhimin Strategjik (GMS), i cili është ngritur në bazë të Urdhrit të Kryeministrit nr. 78, datë 08.05.2006, “Për krijimin e grupeve ministrore të punës për Strategji, Buxhet dhe Integrim, GSBI”, të ndryshuar, ku një rol të veçantë ka luajtur koordinatori i GMS (Nëpunësi Autorizues/Sekretari i Përgjithshëm) në çdo njësi të qeverisjes qendrore.

Për të garantuar një menaxhim financiar dhe kontrolli në përputhje me legjislacionin sa vijon:

- **Vendimit nr. 523, datë 22.09.2021 të Këshillit të Ministrave** “Për përcaktimin e fushës së përgjegjësisë shtetërore të Ministrisë së Arsimit dhe Sportit”.
- **Struktura e Aparatit të MAS është miratuar me Urdhrit të Kryeministrit nr. 144, datë 16.12.2021** “Për miratimin e strukturës dhe organikës së MAS.

• **Rregullorja është Miratuar me Urdhrin e Ministrit nr. 689, datë 15.11.2022** është miratuar "Rregullorja e Brendshme e Ministrisë së Arsimit dhe Sportit", delegohen detyra sipas kërkesave ligjore. Është e rëndësishme të theksohet se zbatimi i sistemeve efikase të MFK-së, ndihmon në përshtatjen më të lehtë të njësisë ndaj ndryshimeve me të cilat ajo do të përballlet në mjedisin e jashtëm apo të brendshëm.

Ministria e Arsimit dhe Sportit për vitin 2023, ka administruar dhe menaxhuar fondet buxhetore, sipas gjashtë programeve të miratuara, të listuar me poshtë:

1. Programi "Planifikim, menaxhim dhe administrim"
2. Programi "Arsimi Bazë"
3. Programi "Arsimi i Mesëm i Përgjithshëm"
4. Programi "Arsimi i Lartë"
5. Programi "Kërkimi shkencor".
6. Programi "Për sportin dhe Rininë".

Fondet e miratuara me ligjin nr.84/2022 "Për buxhetin e vitit 2023" për Ministrinë e Arsimit dhe Sportit për vitin 2023, janë në shumën prej **47 miliard e 174 milion lekë**, krahasuar me shpenzimet publike fondet për arsimin për vitin 2023 arrijnë në **6.8%** dhe ndaj produktit të brendshëm bruto për vitin 2023 janë në nivelin **2.2%**.

Fondet e miratuara në grupin e shpenzimeve kapitale janë 4 miliard e 554 milion lekë osë 9.65% e fondeve të miratuara për Ministrinë e Arsimit dhe Sportit për vitin 2023. Nga të cilat, investime me financim të brendshëm janë 3 miliard e 994 milion ose 86.4% e fondit të investimeve dhe 620 milion lekë ose 13.6% investime me financim të huaj.

Tabela nr. 1_ **Fondet e miratuara me ligjin nr.84/2022 "Për buxhetin e vitit 2023"**, në 000 lekë.

Fondeve Buxhetore të miratuara për vitin 2023, me ligjin nr. 84/2022 "Për buxhetin e vitit 2023", (në 000/LEK)									
Kodi	Emertimi i Institucionit/ Programit	Totali i Shp. Korrente	Shpenzimet Kapitale			Totali i Shpenzimeve e Buxhetore	Struktura ne % e fondeve 2023,	Ndryshimi ne 000 lekë fondeve 2023, ndaj vitin 2022	Ndryshim i ne % fondeve 2023, ndaj vitin 2022
			Financim i Brendshem	Financimi i Huaj	Totali i Shp. Kapitale				
	%	90.34%	86.4%	13.6%	9.65%	100%			
11	Ministria e Arsimit dhe Sportit	42,620,000	3,934,000	620,000	4,554,000	47,174,000	100.0%	1,336,718	2.9%
01110	Planifikimi, Menaxhimi dhe Administrimi	740,879	55,000		55,000	795,879	1.7%	20,732	2.7%
09120	Arsimi Baze (përfshirë parashkollorin)	23,853,434	1,437,000		1,437,000	25,290,434	53.6%	- 131,953	-0.5%
09230	Arsimi i Mesem (i përgjithshëm)	6,868,687	1,162,000		1,162,000	8,030,687	17.0%	435,215	5.7%
09450	Arsimi Universitar	10,400,000							
09770	Fonde për Shkencën	481,000	880,000	300,000	1,180,000	11,580,000	24.5%	1,088,205	10.4%
08140	"Për Zhvillimin e Sportit"	276,000	150,000	20,000	170,000	446,000	0.9%	- 338,571	-43.2%

Buxheti i rishikuar me Aktin Normativ nr.6, datë 14.12.2023 Dhjetor 2023 për Ministrinë e Arsimit dhe Sportit, është në **shumën 47 miliard e 602 milion leke ose 428 milion lekë** ose më shumë 0.9% krahasuar me buxhetin fillestar të miratuar me ligjin vjetor të buxhetit për vitin 2023. Fondet e miratuara me Aktin Normativ nr.6, datë 14.12.2023 Dhjetor 2023 në grupin e shpenzimeve kapitale janë 3 miliard e 347 milion lekë osë 7.03% e fondeve të miratuara për Ministrinë e Arsimit dhe Sportit për vitin 2023. Nga të cilat, investime me financim të brendshëm janë 2 miliard e 964 milion ose 88.6% e fondit të investimeve dhe 383 milion lekë ose 11.4% investime me financim të huaj.

Tabela nr. 1.1 Fondeve e miratuar me ligjin nr. 84/2022 "Për buxhetin e vitit 2023", rishikuar me Aktin Norm nr.6, datë 14.12.2023 për vitin 2023 (në 000/LEK)

Kodi	Emertimi i Institucionit/ Programit	Totali i Shp. Korrente	Shpenzimet Kapitale			Totali i Shpenzimeve Buxhetore	Struktura ne % e fondeve 2023,	Ndryshimi ne 000 lekë fondeve 2023, ndaj vitin 2022	Ndryshim i ne % fondeve 2023, ndaj vitin 2022
			Financim i Brendshem	Financimi i Huaj	Totali i Shp. Kapitale				
		92.96%			7.04%	100%			
11	Ministria e Arsimit dhe Sportit	44,255,000	2,964,000	383,000	3,347,000	47,602,000	100.0%	1,764,718	3.85%
1110	Planifikimi, Menaxhimi dhe Administrimi	740,879	46,000		46,000	786,879	1.65%	11,732	1.51%

9120	Arsimi Baze	24,618,434	1,207,000		1,207,000	25,825,434	54.25%	403,047	1.59%
9230	Arsimi i Mesem (i pergjithshem)	6,868,687	1,022,000		1,022,000	7,890,687	16.58%	295,215	3.89%
9450	Arsimi Universitar	10,700,000	467,000	178,000	645,000	11,345,000	23.83%	853,205	8.13%
9770	Fonde per Shkencen	481,000	72,000	205,000	277,000	758,000	1.59%	-9,910	-1.29%
8140	"Per Zhvillimin e Sportit"	846,000	150,000	0	150,000	996,000	2.09%	211,429	26.95%

Buxheti i rishikuar me Aktin Normativ nr.6, date 14.12.2023 Dhjetor 2023 për Ministrinë e Arsimit dhe Sportit, si dhe nga rritja e fondeve për mbulimin e shpenzimeve të personelit miratuar me VKM, rimarrja e të ardhurave si dhe fondeve grant për IAL publike të kursyera nga viti 2022, është në shumën 51 miliard e 435 milion leke ose 4 miliard e 261 milion lekë.me afro 9.03% me shumë krahasuar me buxhetin fillestar të miratuar me ligjin vjetor të buxhetit për vitin 2023.

Fondet për investime në grupin e shpenzimeve kapitale janë 3 miliard e 347 milion lekë osë 7.03% e fondeve të miratuara për Ministrinë e Arsimit dhe Sportit për vitin 2023. Nga të cilat, investime me financim të brendshëm janë 2 miliard e 964 milion ose 88.6% e fondit të investimeve dhe investime me financim të huaj 383 milion lekë ose 11.4%.

ANEKSI nr.1 Raporti Përmbledhës i Shpenzimeve të Ministrisë/Institucionit Buxhetor Periudha e Raportimit 12-2023 në/lekë

Ministria e Arsimit dhe Sportit		Kodi i grupit				11		
EMËRTIME		Shpenzimet e Ministrisë/Institucionit						
		Periudha raportuese		Periudha raportuese		Periudha raportuese		% e realizimit
		Plani Fillestar Vjetor Viti 2023	Stru e shpenz në %	Plani Vjetor i Rishikuar Viti 2023	Strukt e shpenz në %	Shpenzime Faktike të Periudhës/Progres	Strukt e shpenz në %	
		(3)	(4)	(5)	(6)	(8)	(9)	
							11 (8/5)	
01110	Planifikimi, Menaxhimi dhe Administrimi	795,879,000.00	2	932,561,820.00	2	901,325,387.67	2	97
08140	Zhvillimi i Sportit	446,000,000.00	1	1,102,100,000.00	2	988,057,507.61	2	90
09120	Arsimi Baze (perفشire parashkollorin)	25,290,434,000.00	54	26,688,986,676.00	52	26,546,720,462.93	55	100
09230	Arsimi i Mesem i Larte (AML)	8,030,687,000.00	17	8,148,152,698.00	16	8,023,888,558.02	17	99
09450	Arsimi Universitar	11,594,000,000.00	25	13,693,700,183.00	27	11,466,333,152.60	24	84
09770	Fonde per Shkencen	1,017,000,000.00	2	870,485,783.00	2	696,848,840.03	1	80
Totali i Shpenzimeve buxhetore te Ministrise (Kap 01,02,03,04,05,08,22)		47,174,000,000.00	100	51,435,987,160.00	100	48,623,173,908.86	100	95
Shpenzime nga te Ardhurat Jash limitit (Kap 06)						2,798,547,201.19		
Totali Shpenzimeve te Ministrise						51,421,721,110.05		
600	Paga	24,442,407,000.00	52	34,525,210,958.00	67	33,648,791,698.61	69	98
601	Sigurime Shoqërore	4,387,532,000.00	9	5,762,043,675.00	11	5,496,605,912.50	11	95
602	Mallra dhe Shërbime të Tjera	1,590,431,000.00	3	3,666,903,280.00	7	2,764,634,598.54	6	75
603	Subvencione	0.00	0	0.00	0	0.00	0	0
604	Transferta Korente të Brendshme	10,895,710,000.00	23	1,282,258,813.00	3	1,132,646,084.91	2	88
605	Transferta Korente të Huaja	105,200,000.00	0	266,935,789.00	1	263,814,194.63	1	99
606	Trans per Buxh. Fam. & Individ	1,198,720,000.00	3	2,585,634,644.00	5	2,235,461,515.87	5	87
Nen-Totali Shpenzime Korrente		42,620,000,000.00	90	48,088,987,159.00	94	45,541,954,005.06	94	95
230	Kapitale të Patrupëzuara	0.00	0	0.00	0	0.00	0	0
231	Kapitale të Trupëzuara	3,934,000,000.00	8	2,964,000,000.00	6	2,805,753,248.80	6	95
Nen-Totali Shpenzime Kapitale me financim te brendshem		3,934,000,000.00	8	2,964,000,000.00	6	2,805,753,248.80	6	95
230	Kapitale të Patrupëzuara	0.00	0	0.00	0	247,382,475.00	1	0
231	Kapitale të Trupëzuara	620,000,000.00	1	383,000,001.00	1	28,084,180.00	0	72%
Nen-Totali Shpenzime Kapitale me financim te huaj		620,000,000.00	1	383,000,001.00	1	275,466,655.00	1	72
Totali Shpenzime Kapitale		4,554,000,000.00	10	3,347,000,001.00	7	3,081,219,903.80	6	92
Totali i Shpenz. Buxhetore te Ministrise/Institucionit Buxhetor		47,174,000,000.00	100	51,435,987,160.00	100	48,623,173,908.86	100	95
Shpenzime nga te Ardhurat Jashte limitit (Kap 06)						2,798,547,201.19		
Totali (Korrente + Kapitale + Shpenz.nga te ardh. jashte limti						51,421,721,110.05		
Nen-Totali Shpenzime Korrente ne%						95%		

Burimi: Ministria e Arsimit dhe Sportit, konfirmuar nga sistemi SIFQ i Ministrise se Financës.

Realizimi i buxhetit për shpenzime kapitale me financim të brendshëm për vitin 2023:

- Fondet e buxhetit të rishikuar me financim të brendshëm për vitin 2023, janë në masën 2,964,000,000 lekë
- Fondet e buxhetit të realizuar me financim të brendshëm për vitin 2023, janë në masën 2,805,753,248 lekë ose 95%.

Realizimi i buxhetit për shpenzime kapitale me financim të huaj për 2023

- Fondet e buxhetit të rishikuar me financim të huaj për 2023, janë në masën 383,000,000 lekë
- Buxheti i realizuar me financim të huaj për 2023, janë në masën 275,466,655 lekë ose 72% e planit;

Tabela nr.2 Realizimi i buxhetit për shpenzime kapitale me financim të brendshëm sipas programeve buxhetore për vitin 2023

Emertimi Institucionit	Buxheti Fillestar	Buxheti I	Realizimi vjetor 2023 në	Realizim në %, ndaj
------------------------	-------------------	-----------	--------------------------	---------------------

	2023	Risihikuar 2023	000 lekë	buxhetit te risihikuar per vitin 2023
Ministria e Arsimit dhe Sportit	3,934,000	2,964,000,000	2,798,501,009	94.42%
Planifikimi, Menaxhimi dhe Administrimi	55,000,000	46,000,000	45,021,812	97.87%
Arsimi Baze	1,437,000,000	1,207,000,000	1,144,238,452	94.80%
Arsimi i Mesëm (i përgjithshëm)	1,162,000,000	1,022,000,000	986,224,526	96.50%
Arsimi Universitar	880,000,000	467,000,000	410,259,841	87.85%
Fonde për Shkencën	250,000,000	72,000,000	63,548,283	88.26%
Zhvillimi i Sportit	150,000,000	150,000,000	149,208,095	99.47%

Përgatitja e kërkesave buxhetore afatmesme për periudhën 2024 – 2026, është realizuar mbështetur në objektivat e përcaktuara në strategjinë e zhvillimit të arsimit parauniversitar, strategjinë kombëtare për shkencën, teknologjinë dhe inovacionin, si dhe strategjinë kombëtare për zhvillim dhe integrim, synimeve, objektive afatmesme treguesit e performancës të parashikuara për çdo program buxhetor, produktet, kostot për çdo produkt, përfituesit, sipas programeve buxhetore për periudhën afatmesme 2024-2026, në përputhje me Programin e Qeverisë.

Hartimi i kërkesave buxhetore për periudhën afatmesme 2024-2026, është realizuar sipas standardeve të përcaktuara në ligjin nr. 9936, datë 26.06.2008 "Për Menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, ligjin nr.10296, datë 08/07/2010 "Për menaxhimin Financiar dhe Kontrollin"; të ndryshuar, ligjin nr. 69/2012, datë 21.06.2012, "Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar ; ligjin nr.80/2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë"; ligjin nr. 79/2017 "Për sportin", të ndryshuar; si dhe Udhëzimin nr.7, datë 28.2.2018 të Ministrisë të Financave dhe Ekonomisë,

Për hartimin e kërkesave buxhetore për periudhën afatmesme 2024-2026, me Urdhrin nr. 198 datë 20.4.2023 të Ministrisë të Arsimit dhe Sportit "Për krijimin e grupit për menaxhim Strategjik (GMS) në Ministrinë e Arsimit dhe Sportit (GMS)", është krijuar grupi i menaxhimit strategjik përfshin Ministrin si Kryetar, Zv/Ministrat, Sekretarin e Përgjithshëm, Sekretarin Teknik, si dhe anëtarë të tjerë të cilët janë Drejtorët e Drejtorive në MAS, si dhe drejtues të institucioneve arsimore nacionale ASKAP, DPAP, QSHA, ASCAL, AKSHI, etj, si dhe me Urdhrin nr.199, datë 20.4.2023 të Ministrisë të Arsimit dhe Sportit "Për krijimin e ekipeve të menaxhimit të programeve buxhetore për hartimin e planit afatmesëm buxhetor për periudhën 2023-2025 ", si dhe anëtarë të tjerë të cilët janë Drejtorët e Drejtorive në MAS, si dhe drejtues të institucioneve arsimore nacionale ASKAP, DPAP, QSHA, ASCAL, AKSHI, etj.

- **Hartimi i PBA 2024-2026. (Faza e parë)** Hartimi i projektbuxhetit për periudhën afatmesme 2024-2026, Analiza e detajuar e fondeve për periudhën afatmesme 2020-2022), sipas objektivave të përcaktuara në Vendimi nr. 90, datë 17.2.2021 Këshillit të Ministrave "Për miratimin e programit të reformave ekonomike (erp) 2021–2023"; Vendimit nr. 621, datë 22.10.2021 të Këshillit të Ministrave "Për miratimin e Strategjisë Kombëtare për Arsimin 2021–2026 dhe të planit të veprimit për zbatimin e saj"; Vendimi nr. 90, datë 17.2.2021 Këshillit të Ministrave "Për miratimin e programit të reformave ekonomike (erp) 2021–2023"; Vendim nr. 710, datë 1.12.2017 "Për miratimin e strategjisë kombëtare për shkencën, teknologjinë dhe inovacionin, 2017-2022". Udhëzimit nr.7, datë 28.2.2018 të Ministrisë të Financave dhe Ekonomisë, si dhe Vendimin nr. 195, datë 05.04.2023 të Këshillit të Ministrave "Për miratimin e taveve përgatitore të shpenzimeve të programit buxhetor afatmesëm 2024-2026",
- Shkresa nr. 2546/1, date 02.05.2023 dërguar për Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë;
- Kërkesat "Fonde për Shtese 2024-2026", nga MAS është dërguar shkresa e ne MFE nr. 1641/4, datë 02.05.2023;
- **Hartimi i PBA 2024-2026. (Faza e dytë)** Hartimi i projektbuxhetit për periudhën afatmesme 2024-2026, Analiza e detajuar e fondeve për periudhën afatmesme 2020-2023), sipas objektivave të përcaktuara në Vendimin nr. 11, datë 11.1.2016 të Këshillit të Ministrave , Vendimin nr. 710, datë 1.12.2017 të Këshillit të Ministrave, Vendimin nr. 74, datë 27.1.2016 të Këshillit të Ministrave, Udhëzimit nr.7, datë 28.2.2018 të Ministrisë të Financave dhe Ekonomisë, në Udhëzimi Plotësues, nr. 9, datë 28.2.2022 "Mbi përgatitjen e Programit Buxhetor Afatmesëm 2023-2025", si dhe tavanet e miratuara me Vendimin nr. 436, datë 19.7.2023 të Këshillit të Ministrave "Për miratimin e taveve përfundimtare të shpenzimeve të programit buxhetor afatmesëm 2024-2026".
- Shkresa dërguar për Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë nr. 5072/1, date 31.08.2023;

- Kërkesat “Fonde për Shtese 2024-2026”, nga MAS është dërguar shkresa e ne MFE nr. 5072/4, datë 31.8.2023;

Te gjitha informacionet tabelat standarde te PBA gjenden te botuara ne faqen zyrtare te MAS;
<https://arsimi.gov.al/buxheti-dhe-financat/>;

Të gjithë drejtuesit titullarët, drejtues të nivelit të mesëm apo të ulët në njësi, janë të vetëdijshëm në lidhje me sistemin e menaxhimit financiar edhe kontrollit të brendshëm MFK-së, si dhe kanë përfituar trajnime afatshkurtra më qëllim që të sigurojë:

- a) drejtimin e operacioneve në mënyrë të rregullt, etike, ekonomike, efikase dhe efektive;
- b) përfaqshjen e operacioneve me ligjet, rregulloret, politikat, planet dhe procedurat;
- c) ruajtjen e aktiveve dhe burimeve të tjera kundrejt humbjeve të shkaktuara nga keqadministrimi, shpenzime dhe përdorime të panevojshme, si dhe kundrejt parregullsive dhe mashtrimit;
- d) forcimin e përgjegjësisë menaxheriale për një arritje të suksesshme të objektivave të vendosura;
- e) raportimin financiar në kohë dhe monitorimin e rezultateve të performancës.

<https://arsimi.gov.al/buxheti-dhe-financat/>

Gjatë vitit 2023 një nga problemet kryesore në kuadër të konsolidimit të sistemeve të kontrollit të brendshëm ka qenë konsolidimi i strukturave, në mënyrë që ato të sigurojnë se detyrat, hierarkia, linjat e raportimit dhe përcaktimi i aktiviteteve të kontrollit janë ndarë siç duhet në mënyrë që të sigurohet përmbushja e objektivave afatgjatë, në zbatim të;

- **Vendimit nr. 523, datë 22.09.2021 te Këshillit të Ministrave** “Për përcaktimin e fushës së përgjegjësisë shtetërore të Ministrisë së Arsimit dhe Sportit”.
- **Urdhrit e Kryeministrit nr. 144, datë 16.12.2021** "Për miratimin e strukturës dhe organikës së MAS”.
- **Urdhrit të Ministrit nr.689, datë 15.11.2022** është miratuar "Rregullorja e Brendshme e Ministrisë së Arsimit dhe Sportit", delegohen detyra sipas kërkesave ligjore.
- **Urdhrit nr. 234, datë 19.4.2019** të ministrit përgjegjës për arsimin "Për miratimin e strukturës dhe të organikës së zyrave vendore të arsimit parauniversitar”.

Për institucionet e sistemit arsimor detyrat delegohen sipas kërkesave ligjore sa vijon.

- Ligji nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për Menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar
- Ligji nr.10296, datë 08/07/2010 “Për menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”, të ndryshuar
- Ligji nr. 69/2012, datë 21.06.2012, “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar;
- Ligji nr.80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë“;
- Ligji nr. 79/2017 “Për sportin”, i ndryshuar;
- Ligji nr.84/2022 ,”Për buxhetin e vitit 2023”, i ndryshuar;
- **Vendimit nr. 523, datë 22.09.2021** te Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e fushës së përgjegjësisë shtetërore të Ministrisë së Arsimit dhe Sportit”,
- **Vendimi nr. 98, datë 27.2.2019** i Këshillit të Ministrave “Për krijimin, mënyrën e organizimit e të funksionimit të Agjencisë së Sigurimit të Cilësisë së Arsimit Parauniversitar (ASCAP)”, ristrukturimin e ish-Institutit të Zhvillimit të Arsimit (IZHA) dhe ish-Inspektoriatit Shtetëror të Arsimit (ISHA).
- **Vendimin nr. 99, datë 27.2.2019** i Këshillit të Ministrave “Për krijimin, mënyrën e organizimit e të funksionimit të Drejtorisë së Përgjithshme të Arsimit Parauniversitar”, janë ristrukturuar DAR/ZA-t duke u krijuar **52 Zyra Arsimore Vendore, 4 Drejtori Rajonale të Arsimit Parauniversitar , si dhe Drejtoria e Përgjithshme e Arsimit Parauniversitar, Tiranë.**
- **Vendim nr.109, datë 15.2.2017** “Për organizimin dhe funksionimin e agjencisë së sigurimit të cilësisë në arsimin e lartë e të bordit të akreditimit dhe për përcaktimin e tarifave për proceset e sigurimit të cilësisë në arsimin e lartë”.

- **Vendimin nr.607 datë 31.08.2016** të Këshillit të Ministrave “Për krijimin, përbërjen, organizimin dhe funksionimin e Agjencisë Kombëtare të Kërkimit Shkencor dhe Inovacionit (AKKSHI);
- **Vendimit nr. 621, datë 22.10.2021** të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e Strategjisë Kombëtare për Arsimin 2021–2026 dhe të planit të veprimit për zbatimin e saj”;
- **Vendimi nr. 90, datë 17.2.2021** Këshillit të Ministrave “Për miratimin e programit të reformave ekonomike (erp) 2021–2023”;
- **Vendim nr. 710, datë 1.12.2017** “Për miratimin e strategjisë kombëtare për shkencën, teknologjinë dhe inovacionin, 2017-2022”.
- **Vendim nr. 88, datë 22.2.2023** “Për miratimin e strategjisë kombëtare për zhvillim dhe integrim evropian 2022–2030”;
- **Vendim Nr. 542, datë 20.9.2023** Këshillit të Ministrave "Për miratimin e Strategjisë Kombëtare për Kërkimin Shkencor, Teknologjinë dhe Inovacionin 2023–2030 dhe të planit të veprimit për zbatimin e saj"
- Vendimi nr. 51, datë 26.01.2022 Këshillit të Ministrave “Për miratimin e programit të reformave ekonomike (ERP) 2022–2024”;

Parimi 1 - MJEDISI I KONTROLLIT; Mjedisi i kontrollit përbën themelin ku ngrihen të gjithë komponentët e tjerë të kontrollit të brendshëm, pasi ai ngre strukturën dhe vendos disiplinën.

Faktorët e mjedisit të kontrollit të brendshëm përfshijnë integritetin, vlerat e etikës dhe profesionalizmin e punonjësve të njësisë, filozofinë dhe stilin e punës së titullarit, mënyrën se si drejtuesi shpërndan detyrat dhe ngarkon përgjegjësitë apo si organizon dhe zhvillon punonjësit në njësi.

- Fusha e përgjegjësisë shtetërore të Ministrisë së Arsimit dhe Sportit është miratuar me Vendimin nr. 523, datë 22.09.2021 të Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e fushës së përgjegjësisë shtetërore të Ministrisë së Arsimit dhe Sportit”.
- Struktura e Aparatit të MAS është miratuar me Urdhrin e Kryeministrit nr. 144, datë 16.12.2021 "Për miratimin e strukturës dhe organikës së MAS, delegohen detyra sipas kërkesave ligjore.
- Rregullorja e Brendshme e Ministrisë së Arsimit dhe Sportit", delegohen detyra sipas kërkesave ligjore është miratuar me Urdhrin e Ministrit nr.689, datë 15.11.2022
- Rregullorja e Brendshme për Kodin e Etikës të Ministrisë së Arsimit dhe Sportit", është miratuar me Urdhrin e Ministrit nr.692, datë 18.12.2023.
- Ligji nr.9131, datë 8.9.2003 “Për rregullat e etikës në administratën publike”;
- Vendim nr. 874, datë 29.9.2021 i Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullave për zbatimin e parimeve të etikës, të klasifikimit të veprimtarive të jashtme dhe vlerën e dhuratave, që mund të pranohen gjatë veprimtarisë së nëpunësit të administratës publike”;
- Vendim nr. 109, datë 26.2.2014 të Këshillit të Ministrave “Për vlerësimin e rezultateve në punë të nëpunësve civilë”;
- Periodikisht njohuritë testohen dhe sipas rastit nëpunësit publikë i nënshtrohen trajnimeve sipas vendimi nr. 1037, datë 16.12.2015 të Këshillit të Ministrave “Për procedurat e vlerësimit të nëpunësve civilë për përfitim dhe përditësimin e njohurive shtesë”.
- Vendim nr. 621, datë 22.10.2021 "Për miratimin e strategjisë kombëtare për arsimin 2021–2026 dhe të planit të veprimit për zbatimin e saj".
- Vendim nr. 862, datë 27.12.2022 “Për miratimin e programit të përgjithshëm analitik të projektakteve që do të paraqiten për shqyrtim në Këshillin e Ministrave gjatë vitit 2023”;
- Vendimi Këshillit të Ministrave nr. 781, datë 26.12.2018 "Për garantimin e transparencës në Institucionet publike të arsimit të lartë”;
- Urdhër i Përbashkët nr. 54, datë 30.1.2019, i Ministrit të Arsimit dhe Sportit dhe i ministrit të Financave dhe Ekonomisë "Për miratimin e formatit të publikimit të të dhënave të detajuara mbi të ardhurat dhe shpenzimet financiare të institucioneve publike të arsimit të lartë”.

Parimi 2 – Titullari / Nëpunësi Autorizues (NA) / Bordi apo Këshilli i Drejtuesve demonstrojnë pavarësi dhe përgjegjshmëri në ushtrimin e përgjegjësisë për mbikëqyrje.

Organi mbikëqyrës (Titullari / Nëpunësi Autorizues / Bordi apo Këshilli i drejtuesve në varësi të llojit të njësisë) demonstroi pavarësi në ushtrimin e detyrave dhe ushtron mbikëqyrje për zhvillimin dhe performancën e kontrollit të brendshëm.

Për vitin 2023, në Programin e Përgjithshëm Analitik të Projektakteve (PPAP) të vitit 2023, miratuar në zbatim të Vendim nr. 862, datë 27.12.2022 “Për miratimin e programit të përgjithshëm analitik të projektakteve që do të paraqiten për shqyrtim në Këshillin e Ministrave gjatë vitit 2023”; (*bashkëlidhur matrica më aktet ligjore dhe nënligjore, udhëzime si dhe urdhra të hartuara dhe miratuara për vitin 2023*).

Gjatë vitin 2023 janë hartuar dhe miratuar nw Kuvend, dy projekt ligje :

- Ligji nr. 44/2023 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 69/2012, “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar.
- Ligji nr. 60/2023 “Për trajtimin e veçantë të studentëve që ndjekin programin e integruar të studimit të ciklit të dytë “Mjekësi e Përgjithshme” në institucionet publike të arsimit të lartë”.
- Janë hartuar dhe miratuar në Këshillit të Ministrave 26 vendime;
- Janë hartuar dhe miratuar nga titullarët e MAS-së, 28 **udhëzime** të Ministrit të përgjegjës për arsimin si dhe Udhëzimev të përbashkëta me ministritë e linjës;
- Është dhënë mendim për rreth **74**, projekt-akte të ardhura për mendim nga ministritë e linjës për mendim. (bashkëlidhur kësaj deklarate, tabela analitike e akteve ligjore dhe nënligjore të miratuara në vitin 2023).
- Janë hartuar dhe miratuar nga titullarët e MAS-së rreth **756**, urdhra të brendshëm me karakter të ndryshëm, të Ministrit të Arsimit, dhe Sportit;

Gjatë vitit 2023, janë realizuar raporte monitorimi për institucionet publike dhe private të arsimit të lartë “Zbatimi i ligjshmërisë në institucionet e arsimit të lartë në shërbim të sigurimit të cilësisë dhe sigurimit të standardeve përmes shqyrtimit të dokumentacionit dhe verifikimit të tij në institucion”, raporte monitorimi për verifikimin e kapaciteteve akademike dhe infrastrukturore për certifikimin e kuotave për programet e studimit.

Për vitin akademik 2023-2024 janë paraqitur gjithsej 195 (njëqind e nëntëdhjetë e pesë) aplikime, si më poshtë:

- I. Aplikime për hapje dhe/ose riorganizim të institucionit të arsimit të lartë/degëve të tyre/njësive kryesore
 1. Aplikim për hapje filiali: është paraqitur 1 (një) aplikim, i cili është rrëzuar.
 2. Aplikim për njësi kryesore: janë paraqitur 4 (katër) aplikime. Prej tyre 3 (tri) janë aplikime për hapje dhe 1 (një) është aplikim për riorganizim.

Nga këto, janë miratuar për t’u hapur 2 (dy) njësi kryesore dhe është rrëzuar 1 (një) aplikim për hapje njësi kryesore, e llojit “Akademi”.

Aplikimi i vetëm për riorganizim të njësisë kryesore, është miratuar.

II. Aplikime për hapje dhe/ose riorganizim të programeve të studimit

1. Cikli I

- Bachelor: janë paraqitur 64 (gjashtëdhjetë e katër) aplikime. Prej tyre, 57 (pesëdhjetë e shtatë) janë aplikime për hapje programi studimi dhe 7 (shtatë) janë për riorganizim programi studimi.

Nga këto, janë miratuar për t’u hapur 30 (tridhjetë) programe studimi dhe është miratuar riorganizimi për 7 (shtatë) programe.

Janë rrëzuar 27 (njëzetë e shtatë) aplikime për hapje.

2. Program studimi i integruar i nivelit të dytë

- PIND: janë paraqitur 2 (dy) aplikime për hapje, të cilat janë miratuar.

3. Cikli II

- Master i shkencave: janë paraqitur 36 (tridhjetë e gjashtë) aplikime. Prej tyre, 17 (shtatëmbëdhjetë) janë aplikime për hapje programi studimi dhe 19 (nëntëmbëdhjetë) janë për riorganizim.

Nga këto, janë miratuar për t’u hapur 17 (shtatëmbëdhjetë) programe studimi.

Janë rrëzuar 18 (tetëmbëdhjetë) aplikime për hapje dhe 1 (një) riorganizim.

- Master profesional: janë paraqitur 28 (njëzetë e tetë) aplikime. Prej tyre, 22 (njëzet e dy) janë aplikime për hapje programi studimi dhe 6 (gjashtë) janë për riorganizim.

Nga këto, janë miratuar për t'u hapur 7 (shtatë) programe studimi dhe është miratuar riorganizimi për 6 (gjashtë) programe.

Janë rrëzuar 15 (trembëdhjetë) aplikime për hapje.

- Master ekzekutiv: është paraqitur 1 (një) aplikim për hapje, i cili është refuzuar.
- Master i arteve: është paraqitur 1 (një) aplikim për riorganizim, i cili është miratuar.

4. Cikli III

- Doktoratë: janë paraqitur 26 (gjashtëdhjetë e katër) aplikime për hapje/riorganizim programi studimi.

Nga këto, janë hapur 3 (tri) programe studimi dhe janë miratuar për kalim në fazën e parë të vlerësimit 6 (gjashtë) programe.

Janë rrëzuar 17 (trembëdhjetë) aplikime për hapje dhe riorganizim.

5. Programe studimi të karakterit profesional

Janë paraqitur 12 (dymbëdhjetë) aplikime për hapje programi studimi.

Nga këto, janë miratuar për t'u hapur 3 (tre) programe studimi, 2 (dy) riorganizime programe studimi dhe janë rrëzuar 7 (shtatë) aplikime.

6. Aplikime për mbyllje të programeve të studimit

Janë paraqitur gjithsej 19 (nëntëmbëdhjetë) aplikime për mbyllje programesh studimi dhe është miratuar aplikimi për secilin prej tyre. Këto kërkesa kanë ardhur me shkresë fizike dhe nëpërmjet sistemit *e-Albania*.

7. Aplikime për mbyllje njësi kryesore

Është kryer një aplikim për mbyllje njësi kryesore, i cili është miratuar.

Drejtoria e Burimeve Njerëzore gjatë vitit 2023, ka realizuar:

Në bashkëpunim me DAP, shpalljen e 29 (njëzet e nëntë) pozicione vende vakante në shërbimin civil në aparatit e Ministrisë së Arsimit dhe Sportit. Për këto procedura është dërguar në DAP formati i rekrutimit, si dhe është bërë ndjekja e shpalljes së vendeve vakante në bashkëpunim me Departamentin e Administratës Publike, caktimin e punonjësve të MAS për procedurat në Komisionet e intervistimit për lëvizje paralele dhe pranimit apo ngritjes në detyrë të kandidatëve, në përputhje me aktet ligjore.

Janë finalizuar 24 (njëzet e katër) procedura rekrutimi në shërbimin civil, nga të cilat :

- 8 (tetë) ngritje në detyrë;
 - 3 (tri) lëvizje paralele;
 - 13 (trembëdhjetë) pranime në kategorinë ekzekutive.
-
- 3 (tri) praktika në shërbimin civil për transferimin në strukturat brenda institucionit dhe 1 jashtë institucionit.
 - 6 (gjashtë) praktika për përfundimin e marrëdhënies në shërbimin civil të punonjësve, për shkak të plotësimit të moshës së pensionit të plotë të pleqërisë dhe 1 praktikë për punonjës administrativ.
 - 2 (dy) praktika pezullimi të statusit të nëpunësit civil;
 - 1 (një) praktikë për largim nga shërbimi civil me masë disiplinore (mosparaqitje në institucion);
 - 1 (një) praktikë lirimi nga shërbimi civil për shkak të dorëheqjes,
 - 1 (një) praktikë ndërprerje e marrëdhënies të punës për shkak të emërimit në një institucion tjetër në shërbimin civil.
-

- 2 (dy) praktika për konfirmimin e punonjësve të MAS, si nëpunës civil, pas përfundimit të periudhës 1-vjeçare të provës në shërbimin civil.
- 24 praktika për fillimin e marrëdhënieve financiare të punonjësve për shkak të marrjes së aktit të emërimit nga DAP.
- 3 praktika shpresore me DAP, lidhur me procedurat për risistemin e nëpunësve gjyqfitues.
- 1 praktikë disiplinore ndaj 1 gjyqfituesi, për shkak të mosparaqitjes në pozicionin e punës dhe moskryerjen e detyrave të deleguara.
- 28 (njëzet e tetë) praktika emërimi/lirime të punonjësve në pozicione administrative dhe politike, nga të cilat 18 (tetëmbëdhjetë) emërimet dhe 10 (dhjetë) lirime nga puna.
- 12 (dymbëdhjetë) praktika lidhje kontratë pune me afat 1 vjeçar dhe 3 vendime për zgjidhje kontrate të punësuar sipas vendimit nr.56, date 1.02.2023.
- Përgatitja dhe nënshkrimi i kontratave të 7 praktikantëve (Thirrja VII) që vendosën të ndjekin praktikën e punës pranë MAS, sipas kontratës *tip*, të dërguar nga ministri i Shtetit për Rininë dhe Fëmijët.
- Shqyrtimi i 21 (njëzetë e një) dosjeve të kandidatëve për anëtar Bordi Administrimi, në 7 (shtatë) Institucionet Publike të Arsimit të Lartë, si dhe përgatitja e urdhrave për emërim në detyrë bazuar në vendimet e grupit të punës të ngritur me urdhër ministri.
- Shtimi, ndryshimi dhe plotësimi i të dhënave për 63 (gjashtëdhjetë e tre) punonjës të MAS të cilët janë pjesë e shërbimit civil, të punësuar me kontratë, praktikantë të praktikave të punës dhe punonjës të BFUG.
- Janë shqyrtuar **665** (gjashtëqind e gjashtëdhjetë e pesë) praktika të ardhura nga institucione dhe qytetarë.

II. VLERËSIMI I SISTEMIT TE MENAXHIMIT FINANCIAR DHE KONTROLLIT

Në Ministrinë e Arsimit dhe Sportit, kontrolli i brendshëm është një ndër preokupimet kryesore të menaxhimit të lartë që trajtohen me prioritet nga Titullari i Ministrisë, drejtuesit e programeve buxhetore, nëpunësit autorizues të nivelit të dytë dhe nëpunësit zbatueses duke synuar një mbështetje të gjerë të gjithë komponentëve të menaxhimit financiar dhe kontrollit.

Mbështetur në detyrimet e përcaktuara në Manualin për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin si edhe udhëzimet e dhëna nga Njësia Qendrore e Harmonizimit të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit në Ministrinë e Financave, titullarët e të gjitha njësive janë përgjegjës, për krijimin dhe monitorimin e kontrollit të brendshëm brenda strukturës që drejtojnë.

Ministrinë e Arsimit dhe Sportit duke filluar nga viti 2017-2018 e në vijim nisur nga performanca pozitive e strukturave të menaxhimit financiar, jemi autorizuar nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë për të punuar me të drejtat të plota drejtpërdrejt në modulën e Buxhetit në Sistemin Informatike Financiar të Qeverisë (SIFQ), si Institucione Buxhetore të Nivelit të Parë, sipas hierarkisë me të drejtën e autoritetit për regjistrimin dhe aprovimin e transaksioneve lidhur me buxhetin, kontratave, pagesave, rishpërndarjeve e fondeve të buxhetit, si dhe regjistrimit në sistemin SIFQ të fondeve të miratuara për vitin ushtrimor si dhe për dy vitet pasardhës.

Parimi 3 – Titullari / Nëpunësi Autorizues (NA) krijon strukturat organizative, linjat e raportimit, autoritetet dhe përgjegjësitë.

Titullari / NA i njësisë publike duhet të krijojë një strukturë organizative, të caktojë përgjegjësi dhe të delegojë përgjegjësitë përkatëse për të arritur objektivat e njësisë, duke mirë-përcaktuar gjithashtu edhe linjat e raportimit.

- Në zbatim Vendimit nr. 523, datë 22.09.2021 të Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e fushës së përgjegjësisë shtetërore të Ministrisë së Arsimit dhe Sportit”.

- **Struktura e Aparatit te MAS është miratuar me Urdhrin e Kryeministrit nr. 144, datë 16.12.2021** "Për miratimin e strukturës dhe organikës së MAS.
- **Rregullorja është miratuar me Urdhrin e Ministrit nr.689, datë 15.11.2022** është miratuar "Rregullorja e Brendshme e Ministrisë së Arsimit dhe Sportit", delegohen detyra sipas kërkesave ligjore.
- **Urdhër nr. 234, datë 19.4.2019** të ministrit përgjegjës për arsimin "Për miratimin e strukturës dhe të organikës së zyrave vendore të arsimit parauniversitar".

Qëllimi i kësaj rregulloreje është përcaktimi i rregullave dhe i detyrave të hollësishme të organizimit, funksionimit të brendshëm dhe marrëdhëniet ndërmjet niveleve të ndryshme në Ministrinë e Arsimit dhe Sportit. Kjo rregullore përcakton rregulla mbi koordinimin e funksioneve, administrimin e dokumentacionit, pajisjeve, orarit zyrtar, rregullat e etikës dhe procedura të tjera të menaxhimit të burimeve njerëzore, aseteve, pajisjeve si dhe ato financiare. Në rregullore ekzistojnë gjithashtu përgjegjësitë dhe detyrat e çdo drejtorie e sektori si dhe marrëdhëniet midis tyre, kanalet dhe mënyrat e komunikimit.

Detyrat funksionale të çdo punonjësi janë përcaktuar në përshkrimet e punës, të cilat si rrjedhojë e ndryshimeve strukturore dhe angazhimeve të reja ligjore që drejtoritë duhet të përmbushin në kuadër të funksionimit të tyre, kanë nevojë për rishikim të vazhdueshëm.

Kryesisht mjedisi i kontrollit ndikohet nga struktura organizative e cila është rishikuar për Aparatin e Ministrinë së Arsimit dhe Sportit, si dhe institucionet e sistemit arsimor parauniversitar, në mënyrë që nivelet hierarkike dhe ato të raportimit të jenë të qarta, me lidhje funksionale, si edhe çdo objektiv dhe detyrë të jetë e mbuluar plotësisht dhe pa dublime.

- Rishikimi i funksioneve, detyrave si dhe strukturave është miratuar me **Vendim nr.99, datë 27.2.2019** i Këshillit të Ministrave "Për krijimin, mënyrën e organizimit e të funksionimit të Drejtorisë së Përgjithshme të Arsimit Parauniversitar", për ristrukturimi i DAR/ZA-ve, si dhe Urdhër të ministrit përgjegjës për arsimin nr. 234, datë 19.4.2019 "Për miratimin e strukturës dhe të organikës së zyrave vendore të arsimit parauniversitar".
- Rishikimi i funksioneve, detyrave si dhe strukturave, **Vendimin nr. 98, datë 27.2.2019** i Këshillit të Ministrave "Për krijimin, mënyrën e organizimit e të funksionimit të Agjencisë së Sigurimit të Cilësisë së Arsimit Parauniversitar (ASCAP)", për ristrukturimi Institutit të Zhvillimit të Arsimit (IZHA) dhe Inspektoratit Shtetëror të Arsimit (ISHA), si dhe miratimi i me **Urdhër nr. 69, datë 19.4.2019 të Kryeministrit** "Për miratimin e strukturës dhe të organikës të Agjencisë së Sigurimit të Cilësisë së Arsimit Parauniversitar (ASCAP)".
- **Vendimit nr. 523, datë 22.09.2021** të Këshillit të Ministrave "Për përcaktimin e fushës së përgjegjësisë shtetërore të Ministrisë së Arsimit dhe Sportit".
- Struktura e Aparatit te MAS është miratuar më Urdhrin e Kryeministrit nr. 163, datë 07.10.2017 "për miratimin e strukturës dhe organikës së MAS.
- Struktura e Aparatit te MAS është **miratuar më Urdhrin e Kryeministrit nr. 144, datë 16.12.2021** "Për miratimin e strukturës dhe organikës së MAS.

Në Ministrinë e Arsimit dhe Sportit, mjedisi i kontrollit përbën bazën ku ngrihen të gjithë komponentët e tjerë të kontrollit dhe përfshin vendosjen e objektivave që sigurojnë përmbushjen e misionit të çdo njësie, etikën personale dhe profesionale, strukturën organizative, filozofinë dhe praktikat e menaxhimit të burimeve njerëzore.

Parimi 4 -Njësia publike demonstroi angazhim në realizimin e kompetencave.

Njësitë publike demonstrojnë një angazhim për të tërhequr, zhvilluar dhe mbajtur personel kompetent në përputhje dhe në mbështetje të objektivave të njësisë.

Në mbështetje të nenit 27, të ligjit nr.10296, datë 08.07.2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin", procesi është drejtuar dhe koordinuar nga Grupi për Menaxhim Strategjik (GMS), i cili është ngritur në bazë të Urdhrit të Kryeministrit nr.78, datë 08.05.2006, "Për krijimin e grupeve

ministrorë të punës për Strategji, Buxhet dhe Integrim, GSBI”, i ndryshuar, ku një rol të veçantë ka luajtur koordinatori i GMS (Nëpunësi Autorizues/Sekretari i Përgjithshëm), në çdo njësi të qeverisjes qendrore, **si dhe me drejtuesit e Ekipeve të Menaxhimit të Programeve.**

Hartimi i projektbuxhetit për periudhën afatmesme 2024-2026, është realizuar sipas standardeve të Udhëzimit nr.7, datë 28.2.2018 të Ministrisë të Financave dhe Ekonomisë, si dhe tavanet e miratuara me Vendimin nr. 195, datë 05.04.2023 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e tavanëve përgatitore të shpenzimeve të programit buxhetor afatmesëm 2024-2026”.

- **Urdhri nr. 198 datë 20.4.2023 të Ministrisë të Arsimit dhe Sportit** "Për krijimin e grupit për menaxhim Strategjik (GMS) në Ministrinë e Arsimit dhe Sportit (GMS)", është krijuar grupi i menaxhimit strategjik përfshin Ministrin si Kryetar, Zv/Ministrat, Sekretarin e Përgjithshëm, Sekretarin Teknik, si dhe anëtarë të tjerë të cilët janë Drejtorët e Drejtorive në MAS, si dhe drejtues të institucioneve arsimore nacionale ASKAP, DPAP, QSHA, ASCAL, AKSHI, etj.
- **Urdhri nr.199, datë 20.4.2023 të Ministrisë të Arsimit dhe Sportit** "Për krijimin e ekipeve të menaxhimit të programeve buxhetore për hartimin e planit afatmesëm buxhetor për periudhën 2023-2025 ", si dhe anëtarë të tjerë të cilët janë Drejtorët e Drejtorive në MAS, si dhe drejtues të institucioneve arsimore nacionale ASKAP, DPAP, QSHA, ASCAL, AKSHI, etj.
- **Hartimi i PBA 2024-2026. (Faza e parë)** Hartimi i projektbuxhetit për periudhën afatmesme 2024-2026, Analiza e detajuar e fondeve për periudhën afatmesme 2020-2022), sipas objektivave të përcaktuara në Vendimi nr. 90, datë 17.2.2021 Këshillit të Ministrave “Për miratimin e programit të reformave ekonomike (erp) 2021–2023”; Vendimit nr. 621, datë 22.10.2021 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e Strategjisë Kombëtare për Arsimin 2021–2026 dhe të planit të veprimit për zbatimin e saj”, Vendimi nr. 90, datë 17.2.2021 Këshillit të Ministrave “Për miratimin e programit të reformave ekonomike (erp) 2021–2023”; Vendim nr. 710, datë 1.12.2017 “Për miratimin e strategjisë kombëtare për shkencën, teknologjinë dhe inovacionin, 2017-2022”. Udhëzimit nr.7, datë 28.2.2018 të Ministrisë të Financave dhe Ekonomisë, si dhe tavanet e miratuara me Vendimin nr. 195, datë 05.04.2023 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e tavanëve përgatitore të shpenzimeve të programit buxhetor afatmesëm 2024-2026”, Vendimin nr. 195, datë 05.04.2023 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e tavanëve përgatitore të shpenzimeve të programit buxhetor afatmesëm 2024-2026”,
Shkresa nr. 2546/1, date 02.05.2023 dërguar për Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë;
Kërkesat “Fonde për Shtese 2024-2026”, nga MAS është dërguar shkresa e ne MFE nr. 1641/4, datë 02.05.2023;
- **Hartimi i PBA 2024-2026. (Faza e dytë)** Hartimi i projektbuxhetit për periudhën afatmesme 2024-2026, Analiza e detajuar e fondeve për periudhën afatmesme 2020-2023), sipas objektivave të përcaktuara në Vendimin nr. 11, datë 11.1.2016 të Këshillit të Ministrave , Vendimin nr. 710, datë 1.12.2017 të Këshillit të Ministrave, Vendimin nr. 74, datë 27.1.2016 të Këshillit të Ministrave, Udhëzimit nr.7, datë 28.2.2018 të Ministrisë të Financave dhe Ekonomisë, në Udhëzimi Plotësues, nr. 9, datë 28.2.2022 “Mbi përgatitjen e Programit Buxhetor Afatmesëm 2023-2025”, si dhe tavanet e miratuara me Vendimin nr. 436, datë 19.7.2023 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e tavanëve përfundimtare të shpenzimeve të programit buxhetor afatmesëm 2024-2026”. Shkresa dërguar për Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë nr. 5072/1, date 31.08.2023; Kërkesat “Fonde për Shtese 2024-2026”, nga MAS është dërguar shkresa e ne MFE nr. 5072/4, datë 31.8.2023;
- **Te gjitha informacionet tabelat standarde të PBA gjenden të botuara në faqen zyrtare të MAS; <https://arsimi.gov.al/buxheti-dhe-financat>;**

Parimi 5 -Njësia publike vepron në përputhje me përgjegjshmërinë menaxherial.

Njësia publike duhet të ketë personel të përgjegjshëm në realizimin e përgjegjësisë në lidhje me kontrollin e brendshëm dhe më konkretisht në ndjekjen e objektivave të njësisë.

Për të gjitha njësitë e varësisë të Ministrisë së Arsimit dhe Sportit, Nëpunësi Autorizues/titullari është autorizuar nga **Nëpunësi Autorizues i nivelit të dytë**, në përputhje me Ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”, janë përcaktuar Nëpunësit Autorizues si dhe Nëpunësit Zbatues **si dhe është njoftuar Njësia Qendrore e Harmonizimit të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit në Ministrinë e Financës.**

Në ushtrimin e përgjegjësisë nga titullarët ka procedurë për delegimin e kompetencave bazuar në Kodin e Procedurave Administrative dhe rregulloret e brendshme.

Ne vitin 2022_ Z. Erzen TOLA me shkresë nr. 5976/2 datë 25.10.2022 të Departamenti të Administratës Publike, është liruar nga pozicioni i Drejtorit të Përgjithshëm dhe emërohet Sekretari i Përgjithshëm.

Në vitin 2023 për Sekretarin e Përgjithshëm **me Urdhër nr. 523, datë 15.9.2023** “Për Delegimin e Kompetencave”, të ministrit përgjegjës për arsimin janë të përshkruar qartësisht detyrat që delegohen nga Titullari tek Sekretari i Përgjithshëm.

- Vendimit nr. 523, datë 22.09.2021 të Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e fushës së përgjegjësisë shtetërore të Ministrisë së Arsimit dhe Sportit”.
- Struktura e Aparatit të MAS është miratuar më Urdhrin e Kryeministrit nr. 144, datë 16.12.2021 "Për miratimin e strukturës dhe organikës së MAS.
- Rregullorja është miratuar me Urdhrin e Ministrit nr.689, datë 15.11.2022 është miratuar "Rregullorja e Brendshme e Ministrisë së Arsimit dhe Sportit", delegohen detyra sipas kërkesave ligjore.
- Me Urdhrin e Ministrit nr.692, datë 18.12.2023 është miratuar "Rregullorja e Brendshme për Kodin e Etikës të Ministrisë së Arsimit dhe Sportit",
- Vendimi nr. 98, datë 27.2.2019 Këshillit të Ministrave “Për krijimin, mënyrën e organizimit e të funksionimit të Agjencisë të Sigurimit të Cilësisë të Arsimit Parauniversitar (ASCAP);
- Vendimi nr. 99, datë 27.2.2019 Këshillit të Ministrave “Për krijimin, mënyrën e organizimit e të funksionimit të drejtorisë së përgjithshme të arsimit parauniversitar”;
- Vendimit nr. 621, datë 22.10.2021 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e Strategjisë Kombëtare për Arsimin 2021–2026 dhe të planit të veprimit për zbatimin e saj”,
- VENDIM Nr. 542, datë 20.9.2023 Këshillit të Ministrave "Për miratimin e Strategjisë Kombëtare për Kërkimin Shkencor, Teknologjinë dhe Inovacionin 2023–2030 dhe të planit të veprimit për zbatimin e saj".
- Vendimit nr. 523, datë 22.09.2021 të Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e fushës së përgjegjësisë shtetërore të Ministrisë së Arsimit dhe Sportit”;
- Vendimi nr. 51, datë 26.01.2022 Këshillit të Ministrave “Për miratimin e programit të reformave ekonomike (ERP) 2022–2024”;
- Vendim nr. 710, datë 1.12.2017 Këshillit të Ministrave “Për miratimin e strategjisë kombëtare për shkencën, teknologjinë dhe inovacionin, 2017-2022”.;
- Vendim nr. 88, datë 22.2.2023 “Për miratimin e strategjisë kombëtare për zhvillim dhe integrim evropian 2022–2030”;
- Vendim nr.370, datë 1.6.2022 Këshillit të Ministrave “Për miratimin e strategjisë ndërsektoriale “agjenda digjitale e shqipërisë” dhe të planit të veprimit 2022–2026;

Gjithashtu janë të miratuara përshkrimet e punës për çdo pozicion dhe kryhen vlerësimet vjetore të punës mbi arritjet individuale në punë. Për ngritjen e kapaciteteve të punonjësve realizohen trajnime

të vazhdueshme nga MAS, në bashkëpunim me DAP, si dhe Shkollën Shqiptare të Administratës Publike dhe trajnime të tjera brenda dhe jashtë vendit.

Për vitin 2021, në vijim të situatës së pandemisë COVID -19, trajnimet e Planifikuara për vitin 2021, janë zhvilluar në dy forma online si dhe me prezencë fizike.

B) MENAXHIMI I RISKUT

B.1 Parimi 6 – Njësia Publike specifikon objektivat si bazë për identifikim dhe vlerësim të risqeve në lidhje me këto objektiva.

Përcaktimi i objektivave të njësisë publike është formimi i bazës mbi të cilën zbatohet vlerësimi i riskut dhe krijohen aktivitetet pasuese të kontrollit. Titullarët / NA / Menaxherët përcaktojnë objektivat dhe i grupojnë ato në kategori më gjithëpërfshirëse në të gjitha nivelet e njësisë, në lidhje me aktivitete, raportimet dhe pajtueshmërinë.

Vendosje e objektivave afatmesme, si dhe hartimi i kërkesave buxhetore për vitin 2024-2026, për realizimin e objektivave afatmesme, mbështetet në strategjinë e arsimit parauniversitar të miratuara sipas objektivave të përcaktuara në Vendimin nr. 621, datë 22.10.2021 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e Strategjisë Kombëtare për Arsimin 2021–2026 dhe të planit të veprimit për zbatimin e saj”, Vendimin nr. 90, datë 17.2.2021 Këshillit të Ministrave “Për miratimin e programit të reformave ekonomike (erp) 2021–2023”; Vendim nr. 710, datë 1.12.2017 “Për miratimin e strategjisë kombëtare për shkencën, teknologjinë dhe inovacionin, 2017-2022”, si dhe tavanet e miratuara me Vendimin nr. 195, datë 05.04.2023 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e taveve përgatitore të shpenzimeve të programit buxhetor afatmesëm 2024-2026”, Treguesit e performancës të fondeve për arsimin, objektivat, prioritetet dhe treguesit e synuar të performancës për çdo objektiv, për periudhën 2024-2026 për Ministrinë e Arsimit dhe Sportit, mbështeten në situatën aktuale si dhe në synimet e përcaktuara në programin e Qeverisë si dhe strategjitë e cituara më lart.

Deklarata e Misionit të MAS për vitin 2023, është hartuar në dokumentin e PBA 2023-2025, sipas standardeve të përcaktuara në **Udhëzimit nr.7, datë 28.2.2018** “Për procedurat standarde të përgatitjes së programit buxhetor afatmesëm”.

Raportet e auditimit të brendshëm mbi funksionimin e procesit të menaxhimit të riskut, Ju dërgohen Titullarëve si dhe drejtorive përgjegjëse për aktivitetet apo që kujdesen dhe raportojnë për objektiva, produkte si dhe synimet e pritshme.

Për vitin 2023, në raportet e riskut të parashikuara për vitin 2023, si dhe regjistrat e riskut apo Strategjinë e parashikuar të Riskut për vitin 2023, nisur nga përvaoja e vitit 2019-2020, ku askush nuk e kishte parashikuar situatën e pandemisë COVID -19 apo pasojat e tërmetin Nëntor 2019.

Ndaj për këtë periudhë është punuar në MAS, për të rishikuar programe dhe standarde mësimore, përdorim i burimeve njerëzore, mirë-menaxhimin e kapaciteteve infrastrukturore ne prioritet ngritjen e kapaciteteve njerëzore dhe infrastukturës IT, janë rialokuara apo rishpërndarë burime financiare, me qëllim krijimin e kushteve për mbylljen e vitit akademik 2022-2023, **realizimin e Maturës shtetërore 2023**, si dhe fillimin e vitit shkollor 2023-2024.

Institucionet arsimore janë mbështetur me rreth 1600-1850 punonjës mësimore-ndihmës (mësues-ndihmës), për plotësimin e vendeve të 800-850 punonjësve psiko-socialë.

Janë zhvilluar trajnime online dhe me prezencë fizike me punonjës mësimorë dhe jo mësimorë për periudhën Janar-Dhjetor 2023, të parashikuara më parë. Janë shfrytëzuar për mësimdhënie platforma dhe programeve elektronike, si dhe televizioni kombëtar shqiptar, etj

Procedurat e brendshme dhe politikat për menaxhimin e riskut, nga Drejtoritë apo Institucione jepet informacion mbi risqet e mundshme, si dhe propozime për të vlerësuar dhe ulur kostot e risqeve (psh; procedurat e marrjes apo largimit nga puna, procedurat për prokurime publike, procedurat për lidhje e implementim kontrate të mallrave, shërbimeve dhe rritje së kapaciteteve.)

Monitorime si dhe raportime për fondet buxhetore, procedurat gjyqësore, detyrimet e mbartura apo detyrimet e krijuara rishtazi etj.

Nga analiza e këtij komponenti të mjedisit të kontrollit rezulton që në zbatim të strategjisë së menaxhimit të riskut, gjatë hartimit të objektivave të Njesisë Publike, diskutohen risqet që kanë të bëjnë me përmbushjen e objektivave të njesisë, të përcaktuara gjatë planifikimit të buxhetit vjetor.

Disa nga risqet me te cilat përballat ASCAP si dhe institucionet arsimore të arsimit parauniversitar, janë:

- Në lidhje me objektivin e organizimit të procesit të kualifikimit të mësuesve, ASCAP përballat me riskun e jashtëm që databazat e provimit të mos funksionojnë për shkak të sulmeve të jashtme natyrore ose kibernetike.
- Në lidhje me hartimin e fondit të pyetjeve për testimin e informatizuar “Mësues për Shqipërinë”, ASCAP përballat me riskun e brendshëm që fondet e pyetjeve të humbasin apo të dëmtohen.
- Risk tjetër është dhe dëmtimi i bazës elektronike të të dhënave të kandidatëve pjesëmarrës në provimet e kualifikimit.
- ASCAP përballat gjithashtu me riskun e jashtëm që platforma e trajnimit për mësuesit trajnime@arsimi.gov.al të mos funksionojë si duhet pavarësisht kontrolleve paraprake dhe të vazhdueshme të paisjeve ndërlidhëse.
- Në lidhje me objektivin e ASCAP për vitin 2023, hartimi i programit të klasës së parë TIK, risku me te cilin institucioni është përballur është gjetja e mësuesve me trajnimin dhe edukimin e duhur në fushën e TIK.
- Një objektiv tjetër i ASCAP për vitin 2023 është ngritja e sistemit të menaxhimit të informacionit parauniversitar (SMIP), gjatë ngritjes së të cilit ASCAP u përball me probleme teknike lidhur me hedhjen e të dhënave në SMIP, referuar popullimit të sistemit me lëndët mësimore, seksionet e kurrikulës dhe strukturën e përmbajtjes së planeve mësimore.

B. 2 Parimi 7 - Njësia Publike identifikon dhe analizon risqet për arritjen e objektivave.

Për vitin 2023, hartimi i Regjistrit të riskut dhe i strategjisë së minimizimit të riskut është hartuar nga të gjitha programet buxhetore dhe aktualisht kemi një regjistër përmbledhës të riskut dhe strategjisë së minimizimit të riskut sipas strukturës së rishikuar të programeve buxhetore, objektivave, produkteve, si dhe aktiviteteve, si të fondeve buxhetore të miratuara me ligjin vjetor të buxhetit 2023.

Njësia publike MAS, ka krijuar mekanizmat e vlerësimit të riskut, duke përfshirë këtu, përcaktimin e koordinatorit të riskut, ngritjen e grupit të menaxhimit të risku. **Koordinatori i Riskut është Nëpunësi Autorizues.**

- Urdhri nr. 337, datë 15.6.2022 të Ministrisë të Arsimit dhe Sportit “Për ngritjen e grupeve të punës për monitorimin e Strategjisë Kombëtare të Arsimit 2021-2026 dhe zbatimin e planit të veprimit”;
- Urdhrin nr. 198 datë 20.04.2023 të Ministrisë të Arsimit dhe Sportit "Për krijimin e grupit për menaxhim Strategjik (GMS) në Ministrinë e Arsimit dhe Sportit (GMS)", është krijuar grupi i menaxhimit strategjik përfshin Ministrin si Kryetar, Zv/Ministrat, Sekretarin e Përgjithshëm, Sekretarin Teknik, si dhe anëtarë të tjerë të cilët janë Drejtorët e Drejtorive në MAS, si dhe drejtues të institucioneve arsimore nacionale ASCAL, AKKSHI, etj.
- Urdhri nr.199, datë 20.04.2023 të Ministrisë të Arsimit dhe Sportit "Për krijimin e ekipeve të menaxhimit të programeve buxhetore për hartimin e planit afatmesëm buxhetor për periudhën 2023-2025 ", si dhe anëtarë të tjerë të cilët janë Drejtorët e Drejtorive në MAS, si dhe drejtues të institucioneve arsimore nacionale ASCAL, AKKSHI, etj ;

Mbështetur në objektivat dhe synimet strategjike për periudhën 2022-2024, objektivat e identifikuara në PBA 2024-2026, është hartuar Regjistri i Riskut, për çdo drejtori, si dhe shkalla e vetëvlerësimit të riskut sipas formularëve standard, sipas modeleve e realizuara në manualin për menaxhimin financiar, shembullin e regjistrit të riskut të përgatitur nga Ministria e Financave.

Për vitin 2023, në kuadër të implementimit të një Sistemi Modern të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit dhe Inspektimi Financiar Publik në Shqipëri, në Ministrinë e Arsimit dhe Sportit gjatë vitit 2023, është zhvilluar me tej produkti për përshkrimin e punës sipas drejtorive, plani i punës sipas drejtorive, harta e proceseve të punës, regjistri i riskut, shkalla e vetëvlerësimit të riskut sipas formularëve standard, gjurma e auditimit në procesin e hartimit të buxhetit afatmesëm, gjurma e auditimit në menaxhimin e aktiveve, gjurma e auditimit në procesin e prokurimeve publike, planet e kontrollit të brendshëm, si dhe gjurma e proceseve të punës brenda drejtorive, sektorëve deri tek punonjësit për operacione të veçanta.

Për vitin 2023, hartimi i Regjistrit të riskut dhe i strategjisë së minimizimit të riskut është hartuar nga të gjitha programet buxhetore dhe aktualisht kemi një regjister përmbledhës të riskut dhe strategjisë së minimizimit të riskut sipas strukturës së rishikuar të programeve buxhetore, objektive, produkteve, si dhe aktiviteteve, si të fondeve buxhetore të miratuara me ligjin vjetor të buxhetit 2023.

B.3 Parimi 8 - Njësia Publike vlerëson mundësinë e riskut për mashtrime.

Veprimtaritë e Kontrollit:

Në Ministrinë e Arsimit dhe Sportit, ushtrohen një sërë rregullash dhe procedura veprimi që synojnë reduktimin e risqeve dhe përmbushjen e objektivave, të cilat kanë natyrë kontrolluese, parandaluese apo zbuluese. Gjatë aktiviteteve të ndryshme të punës kryhen kontrole të caktuara që kanë të bëjnë me ndarjen e detyrave. **Për saktësimin e të dhënave të përfshira në një dokument, ushtrohet sistemi me të paktën tre nivele kontrolli për punonjës/firma të autorizuar.**

Urdhër shpenzimet për kryerjen e pagesave autorizohet/ realizohen gjithmonë pasi realizohet kontrollit paraprak nga Sektori i Financës të dokumentacionit shoqërues të urdhër-shpenzimit, nënshkrimit/firmës të Nëpunësit Zbatues, si dhe nënshkrimit të Nëpunësi Autorizues.

Drejtuesit e Ekipeve të Programeve buxhetore "Planifikim Menaxhimi, 01110", "Arsimi Bazë, 09120", "Arsimi i Mesëm i Përgjithshëm, 09230", "Arsimi i Lartë, 09450", "Fonde për Kërkim Fundamental dhe Ekselencë 09770", si dhe fondeve "Për Zhvillimin e Sportit , 08140", janë iniciues të hartimit të PBA-se faza e parë dytë dhe të tretë për periudhën 2022-2024.

Ndërsa për autorizimi i shpenzimeve të programeve respektive kryhet nga drejtoria përkatëse dhe personat e autorizuar, nëpunësi autorizues dhe Nëpunësi Zbatues si dhe nënshkrimit të Nëpunësi Autorizues. Gjithashtu kryhen edhe aktivitete të kontrollit të cilat kanë të bëjnë me monitorimin e detyrave që menaxherët i ngarkojnë stafit, mbi cilësinë dhe afatet e përmbushjes së tyre.

Në MAS janë ngritur dhe funksionon sistemi i hartimit dhe menaxhimit të Buxhetit nëpërmjet sistemit AFMIS, Sistemi i Menaxhimit të Thesarit dhe të Ardhurave, Sistemit Elektronik të Menaxhimit të Informacionit (EMIS) në arsimin parauniversitar Sistemit Elektronik të Menaxhimit të Informacionit, dokumentacionit, arkivave (EDMRS), Vendimin nr. 742, datë 3.12.2021 e Këshillit të Ministrave "Për krijimin e bazës së të dhënave shtetërore të sistemit të menaxhimit të informacionit parauniversitar (SMIP)", është në zbatim SMIP.

B.4 Parimi 9 - Njësia Publike identifikon dhe analizon ndryshimet që mund të ndikojnë në sistemin e kontrollit të brendshëm.

Institucioni merr në konsideratë njësia ndikimet e mundshme të riorganizimit, shtimit të njësive të reja organizative dhe ose ndryshimet e menjëhershme të strukturave ekzistuese në sistemin e kontrollit të brendshëm. Në të gjitha rastet shqyrtohen risqet e mundshme nga ky ndryshim strukturor, së bashku me efektet financiare të cilat mund të sjellin risqet të pa planifikuara. Gjatë vitit 2023 është punuar për hartimin dhe miratimin e akteve nënligjore për implementimin me sukses të reformës në arsimin.

Gjatë kësaj vitit 2023 në MAS është punuar me përkushtim për zhvillimin dhe imlementimin e reformës në arsim parauniversitar dhe arsimine lërtë dhe kërkimin shkencordhe, hartimin e akteve ligjore dhe nënligjore të propozuara në planin e punës për "Marticën e akteve ligjore dhe nënligjore për vitin 2023";

Për vitin 2023, në zbatim të ligjit nr. 69/2012 "Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar si dhe ligjin nr.80/2015 "Për arsimin e lartë ", janë propozuar dhe miratuar nga VKM, (bashkëlidhur aneksi me aktet ligjore dhe nënligjore të miratuara për vitin 2023)

C) AKTIVITETE KONTROLLI.

C.1 **Parimi 10** -Njësia publike përzgjedh dhe zhvillon aktivitete kontrolli.

Proceset dhe aktivitetet e kontrollit në formën e hartave të proceseve të punës, manualeve të proceseve të punës dhe ose procedurave të brendshme për proceset e punës, janë listuar dhe dokumentuar duke adresuar proceset e njësisë për përmbushjen e misionit dhe objektivave të saj. Referuar rregullores së miratuar Rregullorja e miratuar me Urdhrin e Ministrit nr.689, datë 15.11.2022 është miratuar "Rregullorja e Brendshme e Ministrisë së Arsimit dhe Sportit", delegohen detyra sipas kërkesave ligjore.

Takime me stafin për vlerësim të risqeve organizohen takime, trajnime të veçanta si dhe hapat që duhet të ndiqen për rivlerësimin e tyre.

- Urdhri nr. 337, datë 15.6.2022 të Ministrit të Arsimit dhe Sportit "Për ngritjen e grupeve të punës për monitorimin e Strategjisë Kombëtare të Arsimit 2021-2026 dhe zbatimin e planit të veprimit";;
- Urdhrin nr. 198 datë 20.04.2023 të Ministrit të Arsimit dhe Sportit "Për krijimin e grupit për menaxhim Strategjik (GMS) në Ministrinë e Arsimit dhe Sportit (GMS)", është krijuar grupi i menaxhimit strategjik përfshin Ministrin si Kryetar, Zv/Ministrat, Sekretarin e Përgjithshëm, Sekretarin Teknik, si dhe anëtarë të tjerë të cilët janë Drejtorët e Drejtorive në MAS, si dhe drejtues të institucioneve arsimore nacionale ASCAL, AKKSHI, etj.
- Urdhrin nr.199, datë 20.04.2023 të Ministrit të Arsimit dhe Sportit "Për krijimin e ekipeve të menaxhimit të programeve buxhetore për hartimin e planit afatmesëm buxhetor për periudhën 2023-2025 ", si dhe anëtarë të tjerë të cilët janë Drejtorët e Drejtorive në MAS, si dhe drejtues të institucioneve arsimore nacionale ASCAL, AKKSHI, etj ;

GMS në takimet e tij çështje të lidhura me risqet që mund të pengojnë përmbushjen e objektivave të njësisë diskuton për risqet me nivel të lartë apo risqet që pengojnë realizimin e objektivave . Po ne takime dhe mbledhje diskutohet për risqet që mund të pengojnë realizimin e objektivave të njësisë dhe prej këtyre takimeve, menjëherë meren masa për të rialokuar burime financiare , burime njerëzore, apo kërkohen ndërhyrje në aktet ligjore dhe nënligjore;

Menjëherë ngrihen grupet e punës për të hartuar akte ligjore apo nënligjore për të gjetur zgjidhje dhe mënjeluar apo ulur efektet e risqeve. Për të ulur efektet e risqeve në raste të tjera ka pasur rialokime të fondeve me VKM ose akte normative për të ulur efektet e risqeve. Zhvillohen takime me të gjithë Nepunesit autorizues apo nepunesit zbatues për të marrë masa për uljen e risqeve që mund të pengojnë përmbushjen e objektivave të njësisë.

Në institucion ekziston një ndarje e përshtatshme e detyrave, në mënyrë që i njëjti person/strukturë të mos përfshihet njëherësh në zbatimin e dy, ose më shumë detyrave që lidhen me: miratimin, zbatimin dhe regjistrimin e operacioneve financiare, me përjashtim të ndonjë rasti ku një gjë e tillë nuk është e mundur për shkak të mungesave në organikë.

Aktivitet afatgjatë dhe të dhënat personale të punonjësve janë të mbrojtura nga aksesimi dhe përdorimi i personave të paautorizuar.

Informacioni dhe Komunikimi. Harta e proceseve të punës, manualët e proceseve të punës, procedurat dhe politikat e brendshme, evidenca të tjera për procese të përcaktuara që kërkojnë veprimtari kontrolli. Në disa raste realizohen kater nivele kontrolli, specialitetet realizojnë kontrolline formale dhe punojnë për një detyrë/ proces të caktuar, përgjegjesi i sektorit është niveli i parë i kontrollit, drejtori i drejtorisë niveli i dytë i kontrollit, drejtori i përgjithshëm është niveli i tretë i kontrollit deri tek sekretari i përgjithshëm apo titullari që është niveli më i lartë i kontrollit. Edhe për ratet kur një produkt, apo punë e caktuar, me Urdhër të Titullarit realizohet me grup pune, serisht drejtorët e

drejtorive kanë për detyrë ligjore kontrillin e produkteve të realizuara nga GP, e në vijim drejtorët e përgjithshëm, sekretari i përgjithshëm apo titullari që është nivelit më i lartë i kontrollit.

Shkëmbimi i informacionit ndërmjet punonjësve të institucionit si horizontalisht ashtu edhe vertikalisht kryhet sipas rregullores së brendshme të Ministrisë duke respektuar nivelin e hierarkisë, në mënyrë shkresore dhe elektronike.

<http://arsimi.gov.al/ep-content/uploads/2019/11/Rregullore-e-brendshme-2019.pdf>;

C. 2 Parimi 11 -Njësia publike përzgjedh dhe zhvillon aktivitete kontrolli të përgjithshme të kontrollit të teknologjisë.

Kujdes të veçantë i kushtohet komunikimit të informacionit në formën dhe kohën e duhur në mënyrë që të përmbushen sa më mirë përgjegjësitë e punonjësve dhe drejtuesve. Të gjithë punonjësit e Ministrisë së Arsimit dhe Sportit janë trajnuar për përdorim të sigurt dhe të drejtë të komunikimeve elektronike zyrtare bazuar në rregulloret e hartuar nga AKSHI mbi përdorimin e postës elektronike në administratën publike dhe përdorimin e shërbimit të internetit në administratën publike.

MAS ka zbatuar të gjitha standardet TIK të hartuara nga AKSHI në lidhje me ndërtimin dhe mirëmbajtjen e faqes zyrtare të internetit të MAS dhe për ndërtimin e dhomës së serverave në ambientet e MAS, sipas kriterëve të përcaktuara në **vendim nr. 673, datë 22.11.2017 “Përiorganizimin e Agjencisë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit, i ndryshuar**, si dhe Vendimin nr. 36, datë 24.1.2018, Vendimin nr. 448, datë 26.7.2018, Vendimin nr.495, datë 13.9.2017 “Për miratimin e rregullave të përfitimit të shërbimeve publike elektronike, përgjegjëse është Agjencisë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit”, si dhe vendimin nr. 88, datë 14.2.2018 “Për krijimin e Qendrës Ndërinstitucionale të Rrjetit Akademik Shqiptar.

Në rastet e shkeljes së afateve të caktuara janë marrë edhe njoftime për tërheqje vëmendje apo masë disiplinore nga eprorët direkt. Informacioni dhe komunikimi lidhen gjithashtu edhe me teknologjinë e informacionit dhe zbatimin e rregullave të tyre për gjenerimin, përpunimin, përdorimin dhe ruajtjen e informacionit në MAS.

Përfundimi i Sistemit Elektronik të Menaxhimit të Informacionit (EMIS) në arsimin parauniversitar dhe atë universitar ka mundësuar rritjen e eficiencës dhe transparencës në menaxhimin akademik dhe financiar në gjithë sistemin, që nga niveli i shkollës deri tek ai qendror.

Përfundimi i Sistemit Elektronik të Menaxhimit të Informacionit, dokumentacionit, arkivave (EDMRS) në Aparatin e Ministrisë së Arsimit, ka mundësuar rritjen e eficiencës dhe transparencës në menaxhimin të sistemit të menaxhimit, kontrollit, nga niveli më i lartë i ndarjes së detyrave tek specialistët dhe nga specialistët, sipas niveleve të aprovimit deri tek titullarët.

C.3 Parimi 12 -Njësia publike vendos aktivitetet e kontrollit përmes politikave dhe procedurave.

Referuar rregullores së miratuar me Urdhrin e Ministrit nr.689, datë 15.11.2022 është miratuar "Rregullorja e Brendshme e Ministrisë së Arsimit dhe Sportit", delegohen detyra sipas kërkesave ligjore.

Takime me stafin për vlerësim të risqeve organizohen takime, trajnime të veçanta si dhe hapat që duhet të ndiqen për rivlerësimin e tyre, konform fushës së përgjegjës shtetërore, sa vijon:

- Vendimit nr. 523, datë 22.09.2021 të Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e fushës së përgjegjës shtetërore të Ministrisë së Arsimit dhe Sportit”.
- Struktura e Aparatit të MAS është miratuar me Urdhrin e Kryeministrit nr. 144, datë 16.12.2021 “Për miratimin e strukturës dhe organikës së MAS.
- Rregullorja është miratuar me Urdhrin e Ministrit nr.689, datë 15.11.2022 është miratuar "Rregullorja e Brendshme e Ministrisë së Arsimit dhe Sportit", delegohen detyra sipas kërkesave ligjore.

- ligjit nr.9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, te ndryshuar;
- ligjit nr. 48/2014 “Për pagesat e vonuara në detyrimet kontraktore e tregtare”, vendimit nr.50, datë 5.2.2014, të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e strategjisë për parandalimin dhe shlyerjen e detyrimeve të prapambetura e të planit të veprimit”, si dhe të Udhëzimit nr. 5, datë 27.02.2014, të ministrit të Financave “Për shlyerjen e detyrimeve të prapambetura”.
- Udhëzimin nr.22, datë 17.11.2016 të Ministrit të Financave “Për procedurat standarde të monitorimit të buxhetit për njësitë e qeverisjes qendrore”, më qëllim që nëpërmjet monitorimit, analizës dhe performancës financiare të shpenzimeve të buxhetit, si dhe analizave specifike për projekte apo tregues të ndryshëm te rishpërndahen fondet.
- Udhëzimi Nr. 30 datë 27.12.2011 të Ministrit të Financave “PËR MENAXHIMIN E AKTIVEVE NË NJËSITË E SEKTORIT PUBLIK”, i ndryshuar;
- Udhëzimin nr.8, datë 09.03.2018 të Ministrit të Financave “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”;
- Vendimin nr. 98, datë 27.2.2019 i Këshillit të Ministrave “Për krijimin, mënyrën e organizimit e të funksionimit të Agjencisë së Sigurimit të Cilësisë së Arsimit Parauniversitar (ASCAP)”, për ristrukturimi Institutit të Zhvillimit të Arsimit (IZHA) dhe Inspektoratit Shtetëror të Arsimit (ISHA);
- Vendim nr.99, datë 27.2.2019 i Këshillit të Ministrave “Për krijimin, mënyrën e organizimit e të funksionimit të Drejtorisë së Përgjithshme të Arsimit Parauniversitar”, për ristrukturimi i DAR/ZA-ve,;
- Urdhër të të ministrit përgjegjës për arsimin nr. 234, datë 19.4.2019 "Për miratimin e strukturës dhe të organikës së zyrave vendore të arsimit parauniversitar".
- Urdhër nr. 69, datë 19.4.2019 të Kryeministrit "Për miratimin e strukturës dhe të organikës të Agjencisë së Sigurimit të Cilësisë së Arsimit Parauniversitar (ASCAP)".
- Urdhri nr. 337, datë 15.6.2022 të Ministrit të Arsimit dhe Sportit “Për ngritjen e grupeve të punës për monitorimin e Strategjisë Kombëtare të Arsimit 2021-2026 dhe zbatimin e planit të veprimit”;
- Urdhrin nr. 198 datë 20.04.2023 të Ministrit të Arsimit dhe Sportit "Për krijimin e grupit për menaxhim Strategjik (GMS) në Ministrinë e Arsimit dhe Sportit (GMS)", është krijuar grupi i menaxhimit strategjik përfshin Ministrin si Kryetar, Zv/Ministrat, Sekretarin e Përgjithshëm, Sekretarin Teknik, si dhe anëtarë të tjerë të cilët janë Drejtorët e Drejtorive në MAS, si dhe drejtues të institucioneve arsimore nacionale ASCAL, AKKSHI, etj.
- Urdhrin nr.199, datë 20.04.2023 të Ministrit të Ministrisë të Arsimit dhe Sportit "Për krijimin e ekipeve të menaxhimit të programeve buxhetore për hartimin e planit afatmesëm buxhetor për periudhën 2023-2025 ", si dhe anëtarë të tjerë të cilët janë Drejtorët e Drejtorive në MAS, si dhe drejtues të institucioneve arsimore nacionale ASCAL, AKKSHI, etj ;

Në MAS në bashkëpunim me Agjencinë Kombëtare të Informacionit (AKSHI), janë duke u zhvilluar programe nga Drejtoria e Teknologjisë Informacionit dhe Komunikimit, skema për back-up e database-ve dhe aplikacioneve të zhvilluara për Drejtorinë e Shërbimeve të Përgjithshme, Drejtorinë e Buxhetit dhe Menaxhimit Financiar, QSHA (ish-AKP), IZHA ISHA edhe Qendra e Shërbimeve të Rrjetit Telematik. Skemat back-up janë të testuara dhe të stimuluar në rast se sistemi do të ketë një pikë dështimi.

MAS ka zbatuar të gjitha standardet TIK të hartuara nga AKSHI në lidhje me ndërtimin dhe mirëmbajtjen e faqes zyrtare të internetit të MAS dhe për ndërtimin e dhomës së serverave në ambientet e MAS, sipas kriterëve të përcaktuara në **vendim nr. 673, datë 22.11.2017 “Për riorganizimin e Agjencisë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit, i ndryshuar** , si dhe Vendimin nr. 36, datë 24.1.2018, Vendimin nr. 448, datë 26.7.2018, Vendimin nr.495, datë 13.9.2017 “Për miratimin e rregullave të përfitimit të shërbimeve publike elektronike, përgjegjëse është

Agjencisë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit”, si dhe vendimin nr. 88, datë 14.2.2018 “Për krijimin e Qendrës Ndërinstitucionale të Rrjetit Akademik Shqiptar.

C.4 Parimi 13 -Njësia Publike merr gjeneron dhe përdor informacion cilësor.

Në MAS janë disa llojet raportimit periodik brenda njësisë që i dorëzohen menaxherëve, **Memo Informuese** për çështje të veçanta, informacione, raporte monitorimi, raporte inspektive, si dhe raporte auditimi të AB. Për monitorimin e proceseve dhe aktiviteteve përdoren një sërë procedurash nga titullarët, nëpunësit Autorizues dhe zbatues si dhe drejtuesit e tjerë të lartë. Në përgjithësi raportohet mbi realizimin e buxhetit, produkteve, treguesve apo indikatorëve të miratuar për e monitorimin strategjive dhe objektive, si dhe standardeve të përcaktuara në PBA. Sistemi i raportimit manual dhe/ose elektronik në MAS , me email apo sistemi i ERDMS, jep informacion për monitorimin e progresit në arritjen e objektivave të njësisë në tërësi dhe të njësive të vartësisë të saj, nëse ka dhe kundrejt njësisë qendrore. Procedurat e monitorimit mbështeten në standardet e përcaktuara me:

- Udhëzim nr. 9, datë 20.3.2018 i Ministrit të Financave dhe Ekonomisë "Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit", i ndryshuar .
- Udhëzimin nr. 22 datë 17.11.2016 “Për procedurat standarde të monitorimit të buxhetit në Njësitë e Qeverisjes Qendrore”,
- Vendimin nr. 781, datë 26.12.2018 Këshillit të Ministrave "Për garantimin e transparencës në Institucionet publike të arsimit të lartë"
- Urdhër i Përbashkët nr. 54, datë 30.1.2019, të ministrit përgjegjës për arsimin dhe i ministrit të Financave dhe Ekonomisë "Për miratimin e formatit të publikimit të të dhënave të detajuara mbi të ardhurat dhe shpenzimet financiare të institucioneve publike të arsimit të lartë".

Raportet e brendshme dhe të jashtme lidhur me objektivat, aktivitete dhe produktet e realizuara. Raportime financiare dhe operacioneve mujore, 3-mujore, 4-mujore, progresive dhe vjetore. Rregullat dhe procedurat e brendshme që lidhen me informacionin.

Në zbatim të ligjit nr.9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, ligjit nr.99/2018 “Për buxhetin e vitit 2019”, i ndryshuar, ligjit nr. 48/2014 “Për pagesat e vonuara në detyrimet kontraktore e tregtare”, Vendimit nr.50, datë 5.2.2014, të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e strategjisë për parandalimin dhe shlyerjen e detyrimeve të prapambetura e të planit të veprimt”, si dhe të udhëzimit nr. 5, datë 27.02.2014, të ministrit të Financave “Për shlyerjen e detyrimeve të prapambetura”.

Monitorimi kryhet nëpërmjet monitorimit dhe performancës financiare të shpenzimeve të buxhetit, analizave të zbatimit të buxhetit sipas standardeve të përcaktuara në **Udhëzimin nr.22, datë 17.11.2016** të Ministrit të Financave “Për procedurat standarde të monitorimit të buxhetit për njësitë e qeverisjes qendrore”, si dhe **Udhëzimin nr.14, datë 30.05.2023** të Ministrit të Financave “Për procedurat standarde të monitorimit të buxhetit për njësitë e qeverisjes qendrore”, është hartuar dhe raportuar në Ministrinë e Financës dhe Ekonomisë, për vitin 2023.

Nga Ekipet e Menaxhimit të Programeve për çdo program, si dhe Drejtorja e Buxhetit dhe Menaxhimit Financiar në MAS janë përgatitur raporte për çdo 3-mujor, në progresiv 6- mujor, dhe vjetor për vitin 2023.

Informacion mbi raportimin periodik të detyrimeve të prapambetura, të krijuara rishtazi për periudhën.

Gjatë vitit financiar më shumë se 80 institucione të sistemit të arsimit, si dhe 61 njësi të vetëqeverisjes vendore, raportojnë në lidhje me implementimin e kontratave, detyrimeve, numrin e punonjësve, projektet me financimin të huaj që po implementojnë. Raporte monitorimi, si dhe raporte apo plane pune të realizuara. Informacion mbi raportimin periodik të detyrimeve të prapambetura, të krijuara rishtazi për periudhën Janar-Dhjetor 2023

- Shkresa nr.673, datë 01.02.2023, dërguar në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë “Informacion mbi raportimin periodik të detyrimeve të prapambetura, të krijuara rishtazi per vitin 2022”, për periudhën Janar -Dhjetor 2022.:(mbështetur në raportimet financiare te 80 institucione të sistemit të arsimit)
- Shkresa nr.2394/1, datë 03.05.2023, dërguar në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë “Informacion mbi raportimin periodik të detyrimeve të prapambetura, të krijuara rishtazi per 3-mujorin e pare Janar-Mars 2023”;
- Shkresa nr.4140/53, datë 15.07.2023, dërguar në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë “Informacion mbi raportimin periodik të detyrimeve të prapambetura, të krijuara rishtazi per 6-mujorin e pare Janar-Qershor 2023”;
- Shkresa nr.6393/7, datë 17.10.2023, dërguar në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë “Informacion mbi raportimin periodik të detyrimeve të prapambetura, të krijuara rishtazi per 9-mujorin Janar-Shtator 2023”;
- Shkresa nr.372/28, datë 05.02.2024 , dërguar në Ministrinë e Financave “Informacion mbi raportimin periodik të detyrimeve të prapambetura, të krijuara rishtazi per vitin 2023”;
- Përgatitja e raportit vjetor të konsoliduar të Pasqyrave Financiare për vitin 2022; Shkresa dërguar për Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë nr. 2802, date 28.04.2023;

Raportet e monitorimit të buxhetit publikohen në faqen zyrtare të ministrisë të linjës, të cilat shfaqen edhe në faqen zyrtare të ministrisë përgjegjëse për financat nëpërmjet lidhjes së vendosur me faqet zyrtare të ministrive.

Raportet monitorimi, si dhe raporte apo plane pune te realizuara gjatë vitit 2023.

- Shkresa nr. 1389/1, datë 01.03.2023 dërguar në Ministrinë e Financave dhe të Ekonomisë "Dërgohet Deklarata për Cilësinë e Sistemit të Kontrollit të Brendshëm si dhe Pyetësorine Vetëvlerësimit të Cilësisë për vitin 2022"
- Shkresa nr.1389/3 datë 01.03.2023, dërguar në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë “Dërgohet raportim i Monitorimit per periudhen Janar-31 Dhjetor 2022”
- Shkresa nr.3456, datë 30.5.2023, dërguar në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë “Dërgohet raportim i Monitorimit per periudhen 4-mujore Janar-30 Prill 2023”
- Shkresa nr.6027, datë 29.09.2023, dërguar në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë “Dërgohet raportim i Monitorimit per periudhen 8 mujore Janar-31 Gusht 2023”;
- Shkresa _raportimi mujore Projekteve me Financim te brendshem si dhe Financim te Huaj per vitin 2023, dërguar në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë.
- Shkresa _raportimi 3-6-9-12 mujore i shpenzimeve dhe te ardhurave ne Valute me Financim te brendshem si dhe Financim te Huaj per vitin 2023, dërguar në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë.

Përveç monitorimit të vazhdueshëm titullari i MAS dhe **nëpunësi autorizues përdor edhe auditimin e brendshëm të njësisë**. Në MAS, Drejtori i Njësisë së Auditimit të Brendshëm raporton direkt tek titullari, për çdo rast të auditimit të kryer në njësitë shpenzuese. Auditimi i brendshëm përveç kontrollit, konsiston edhe në dhënien e këshillave apo rekomandime të cilat kanë për qëllim përmirësimin e punës së MAS drejt arritjes së objektivave.

C. 5 Parimi 14 -Njësia Publike përdor komunikimin e brendshëm.

Sistemi i raportimit manual dhe/ose elektronik në MAS, me e-mail apo sistemi i ERDMS, jep informacion për monitorimin e progresit në arritjen e objektivave të njësisë në tërësi dhe të njësive të vartësisë të saj, nëse ka dhe kundrejt njësisë qendrore.

Në MAS ekzistojnë procedura për të siguruar që menaxherët dhe personeli i njësisë publike të informohen për vendimet, projektet / nismat e njësive të tjera/ njësisë qendrore, që mund të ndikojnë në përgjegjësitë dhe detyrat e tyre.

Për të gjitha projektet, ngrihen Grupe Punë për realizimin e akteve, projektvendimeve , rregulloreve apo nisma të një rëndësie të veçantë. të gjitha projekte dërgohen për mendim në formë elektronike apo të shoqëruara më MEMO zyrtare.

Për projektligje, projektvendime sipas procedurave zhvillohen dëgjesa publike me aktorët dhe faktorët e interesit, dërgohen për mendim në ministrinë e linjës, apo sipas rastit dhe tek Komisioneri për Diskriminimin si dhe entet fetare e deri në OJQ që mbrojnë interesat e fushës së arsimit.

Te gjitha aktet sa me lart botohen paraprakisht ne faqen e e-Akteve, pas miratimit ne faqen zyrtare te MAS sipas rubrikave përkatëse.

<https://arsimi.gov.al/category/ligje/>;

<https://arsimi.gov.al/category/vkm/>;

<https://arsimi.gov.al/category/urdhera/>;

<https://arsimi.gov.al/category/udhezime/>;

<https://arsimi.gov.al/category/konsultim-publik/>;

E. MONITORIMI

E.1 Parimi 16 - Njësia Publike përzgjedh, zhvillon dhe kryen vlerësime të vazhdueshme dhe / ose të veçanta të sistemit të kontrollit të brendshëm.

Në Ministrinë e Arsimit dhe Sportit , **monitorimi** realizohet sipas standardeve të përcaktuara në ligjin nr.9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, ligjin nr. 48/2014 “Për pagesat e vonuara në detyrimet kontraktore e tregtare”, Vendimin nr.50, datë 5.2.2014, të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e strategjisë për parandalimin dhe shlyerjen e detyrimeve të prapambetura e të planit të veprimit”; Udhëzimit nr. 5, datë 27.02.2014, të ministrisë të Financave “Për shlyerjen e detyrimeve të prapambetura”; Udhëzimin nr.22, datë 17.11.2016 të Ministrisë të Financave “Për procedurat standarde të monitorimit të buxhetit për njësitë e qeverisjes qendrore”, më qëllim që nëpërmjet monitorimit, analizës dhe performancës financiare të shpenzimeve të buxhetit, si dhe analizave specifike për projekte apo tregues të ndryshëm të rishpërndahen fondet; Udhëzimin nr.8, datë 09.03.2018 të Ministrisë të Financave “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”;

Konform fushës së përgjegjësisë shtetërore të Ministrisë së Arsimit dhe Sportit është miratuar me Vendimin nr. 523, datë 22.09.2021 të Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e fushës së përgjegjësisë shtetërore të Ministrisë së Arsimit dhe Sportit”, struktura e Aparatit të MAS është miratuar me Urdhrin e Kryeministrit nr. 144, datë 16.12.2021 "Për miratimin e strukturës dhe organikës së MAS.rregullores të miratuar me Urdhrin e Ministrisë nr.689, datë 15.11.2022 është miratuar "Rregullorja e Brendshme e Ministrisë së Arsimit dhe Sportit", ku delegohen detyra sipas kërkesave ligjore, **për të realizuar vlerësime të vazhdueshme ose të veçanta të sistemit të kontrollit të brendshëm** Ministria e Arsimit dhe Sportit ngre grupe pune me Urdhri nr. 337, datë 15.6.2022 të Ministrisë të Arsimit dhe Sportit “Për ngritjen e grupeve të punës për monitorimin e Strategjisë Kombëtare të Arsimit 2021-2026 dhe zbatimin e planit të veprimit”;

III. GJETJET DHE REKOMANDIMET E AUDITIMIT TË BRENDSHËM DHE TË JASHTËM DHE INSPEKTORIATIT SHTETËROR TË ARSIMIT.

Funksioni i Auditimit të Brendshëm, si veprimtari e pavarur ndihmon menaxhimin e subjekteve publike për arritjen e objektivave të tyre, duke vlerësuar në thellësi sistemet e menaxhimit financiar dhe të kontrollit të brendshëm , me qëllim që të përcaktojnë nëse ato funksionojnë në mënyrë eficiente për arritjen e objektivave, duke ofruar siguri objektive dhe këshillim për të shtuar vlerën, duke nxitur ndryshime që përmirësojnë veprimtarinë e menaxhimit dhe rritjen e përgjegjëshmërisë.

Struktura dhe organizimi i Drejtorisë së Auditimit të Brendshëm është në zbatim të Urdhrit të Kryeministrit nr.186, datë 18.10.2013 “Për miratimin e strukturës dhe të organikës së Ministrisë së Arsimit dhe Sportit”, **e rishikuar me** Urdhrin e Kryeministrit nr. 163, datë 07.10.2017 "Për miratimin e strukturës dhe organikës së MAS". <http://arsimi.gov.al/ep-content/uploads/2019/11/Rregullore-e-brendshme-2019.pdf>;

Rregullorja është Miratuar me Urdhrin e Ministrit nr.352, datë 17.6.2019, është miratuar "Rregullorja e Brendshme e Ministrisë së Arsimit dhe Sportit", delegohen detyra sipas kërkesave ligjore;

MONITORIMI I SISTEMIT DHE SIGURIMI I CILËSISË

Për të rritur cilësinë e auditimeve, në vitin 2023, është kryer në vazhdimësi rishikimi i punës së audituesve dhe vlerësimi i cilësisë së auditimit.

Të gjitha proceset e auditimit (planifikimi, procedura e auditimit, raportet paraprake, raportet finale, memorandumet, evadimi i materialeve etj), janë rishikuar sipas kërkesave të pikës 4.8 të Kapitullit IV dhe të pikës 8 të Kapitullit VIII, të Manualit të Auditimit të Brendshëm. Rishikimi u cilësisë së punës kryhet nga përgjegjësi i grupit të auditimit, si dhe nga drejtuesi i Drejtorisë së Auditimit të Brendshëm (sipas aneksit 7). Grupi i punës që merr pjesë në një mision auditimi, është vlerësuar vazhdimisht nga performanca, përvoja dhe kualifikimet e gjithsecilit. Përmirësimi i programit të angazhimit, ka qenë prioritet i vazhdueshëm i punës së auditit. Procesi i auditimit është mbikëqyrur rregullisht, duke respektuar programin e auditimit dhe trajtimin e problemeve që mund të lindin gjatë një programi angazhimi.

Funksioni i Auditimit të Brendshëm, si veprimtari e pavarur ndihmon menaxhimin e subjekteve publike për arritjen e objektivave të tyre, duke vlerësuar në thellësi sistemet e menaxhimit financiar dhe të kontrollit të brendshëm, me qëllim që të përcaktojë nëse ato funksionojnë në mënyrë eficiente për arritjen e objektivave, duke ofruar siguri objektive dhe këshillim për të shtuar vlerën, duke nxitur ndryshime që përmirësojnë veprimtarinë e menaxhimit dhe rritjen e përgjegjshmërisë.

Drejtoria e Auditimit të Brendshëm, mbështetur në planin vjetor, të miratuar nga Ministri me prot/ nr. 6998, datë 24/10/2022, ka përcaktuar objektivat me programe konkrete, për realizimin e misionit të auditimit si:

- Dhënies përparësi për auditim, atyre fushave që janë vlerësuar me riskë të mesëm dhe të lartë ;
- Përmirësimin e kapaciteteve të auditit;
- Përmirësimin e programeve dhe metodologjisë së auditimit.

Njësia e Auditimit të Brendshëm, në institucionet e audituara, ka kryer vlerësimin e sistemit të kontrollit të brendshme dhe nga këto vlerësime vërehet se, këto sisteme janë ngritur dhe janë vlerësuar me nivel mesatar.

Analiza e programeve të AB, për periudhën raportuese:

- Hartimi i planit vjetor, është bazuar në kapacitetet e planifikuara të burimeve që ka kjo drejtori si dhe në vlerësimin e riskut të institucioneve të varësisë.
- Për periudhën (Janar - Dhjetor) 2023, ishin planifikuar për t'u realizuar 19 auditime në 19 institucione dhe janë realizuar 18 auditime në 18 institucione.

Rekomandimet e propozuara gjithsej 160, nga këto:

- Rekomandime për përmirësimin e sistemeve, gjithsej 45
- Rekomandime për përmirësimin e kuadrit ligjor, gjithsej 0
- Rekomandime të karakterit organizativ, gjithsej 81
- Rekomandime për arkëtime, gjithsej 5
- Rekomandime të tjera, gjithsej 29

Auditimi i sistemit të kontrollit të brendshëm, është vlerësuar si një proces i pandërprerë dhe i vazhdueshëm gjatë gjithë veprimtarisë, ku marrin pjesë të gjithë punonjësit e subjektit të audituar, ky vlerësim është bërë sipas këtyre komponentëve:

- Për ambientin e kontrollit të brendshëm;
- Për vlerësimin e riskut;
- Për kontrollin e aktivitetit operacional;
- Për sistemin e informimit dhe të komunikimit;
- Për monitorimin;
- Sistemet e kontrollit të brendshëm për administrimin e aktiveve.

Prioritetet në vazhdim:

- Përmirësimi i procesit të vlerësimit të riskut, mbi bazën e të cilit të hartohen programet e angazhimit të auditimeve;
- Zgjerimi i aftësive për të kryer auditime mbi bazë risku dhe sistemi;
- Dobishmëria dhe efektiviteti me impakt konkret, në arritjen e objektivave të institucioneve, nëpërmjet dhënies së rekomandimeve për njësitë e audituara.

V. REKOMANDIME TË PËRGJITHSHME PËR PËRMIRËSIMIN E KUADRIT LIGJOR DHE NËNLIGJOR MBI SISTEMIN E KONTROLLIT TË BRENDSHËM.

